



STUDIME PASDIPLOMIKE

PUNIM MAGJISTRATURE

Tema:

**EFEKTET E MARKETINGUT DIGJITAL NË LOJALITETIN E KONSUMATORËVE TË KOMPANIVE
TELEKOM DHE A1**

Student:

Ulpiana Bejta

Mentor:

Prof. Dr. Jusuf Zeqiri

Shkup, 2023

Deklarata e origjinalitetit

Unë Ulpiana Bejta, me përgjegjësinë time më të lartë deklaroj se punimi me titull “Efektet e marketingut digjital në lojalitetin e konsumatorëve të kompanive Telekom dhe A1” është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë më parë në ndonjë institucion tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë, i tëri apo pjesërisht. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të citateve dhe referencave të tjera (për të cilat është ruajtur burimi/referencat/ fusnotat).

Nënshkrimi: _____

Ulpiana Bejta

Mirënjohje

Dëshiroj të shpreh mirënjohje të thellë për Mentorin tim Prof. Dr. Jusuf Zeqiri i cili më udhëzoi dhe më mbështeti me shumë durim gjatë procesit të përgatitjes së tezës sime të magjistraturës. Dera e tij ishte gjithmonë e hapur sa herë që kisha një pyetje në lidhje me kërkimin ose shkrimin tim dhe më drejtonte në drejtimin e duhur sa herë që ai mendonte se kisha nevojë për të.

Dëshiroj të shpreh mirënjohje edhe për profesorët dhe administratën e Universitetit të Evropës Juglindore në Shkup për udhëzimin gjatë procesit tim arsimor gjatë studimeve pasuniversitare.

Më duhet të shpreh mirënjohjen time shumë të thellë për prindërit e mi për mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm gjatë gjithë viteve të studimit dhe gjatë procesit të kërkimit dhe shkrimit të kësaj teze. Kjo arritje nuk do të ishte e mundur pa to.

Faleminderit.

ABSTRAKT

Tashmë konsumatori është bërë mekanizmi kryesor që ndihmon dhe siguron funksionimin e çdo ndërmarrjeje. Studimi i sjelljeve të tij është çelësi drejt përfitimit të suksesshëm dhe prodhimit të produkteve të duhura. Në epokën moderne, në të cilën po jetojmë dhe të cilën e karakterizon një dinamikë e zhvillimit në të gjitha fushat e jetës, është vërtetuar se krijimi i kënaqësisë dhe lojalitetit të konsumatorëve është çelësi i fitimit të çdo ndërmarrjeje. Kohëve të fundit po vërejmë shumë shpesh të flitet apo shkruhet për ndërmarrjet që po përdorin teknologjinë moderne apo ndërmarrjet e “orientuara kah marketingu digjital”. Këto ndërmarrje e vendosin konsumatorin në qendër të të gjitha aktiviteteve të tyre.

Në këtë punim do të shtjellohet studimi i efektit të ndryshimit të zhvillimit teknologjik në sjelljen e konsumatorëve digjital dhe faktorët që ndikojnë në procesin e marrjes së vendimeve për blerje të konsumatorëve digjital, përkatësisht në lojalitetin e konsumatorëve në kompanitë **Telekom** dhe **A1**.

Në pjesën e parë të punimit, është bërë një shqyrtim i literaturës të autorëve të ndryshëm vendas dhe të huaj, artikujve, revistave shkencore dhe mendimeve të tyre rreth marketingut dhe strategjive të marketingut, publikimeve të ndryshme lidhur me kuptimin e rolit dhe rëndësinë e marketingut dhe strategjitë e marketingut lidhur me ndërmarrjet. Rishikimi dhe përmbledhja nga literaturat e analizuar kanë krijuar një bazë të fortë e cila do të shërbej si pikë referimi për vazhdimin në pjesën praktike të hulumtimit.

Në pjesën e dytë të punimit është folur për sjelljen konsumatore, grupet e marrëdhënieve me klientët, faktorët në sjelljen konsumatore dhe lojalitetin e konsumatorëve të cilët me synim të përmbushjes së nevojave të tyre, ndikojnë drejtpërdrejtë në përzgjedhjen e kompanisë të cilës do t'i qëndrojnë besnike.

Ndërsa, në pjesën e tretë të punimit, është bërë një hulumtim praktik nëpërmjet teknikës së pyetësorit anketues, ku janë përzgjedhur për anketim 230 konsumatorë të kompanive telefonike Telekom dhe A1 në mënyrë elektronike. Nëpërmjet këtij hulumtimi, është tentuar që të nxirren të dhëna për të kuptuar sa janë konsumatorët besnik dhe të kënaqur me kompanitë telefonike

Në fund të punimit, nga të dhënat e fituara nga pyetësorët anketues është arritur deri te përfundimet e caktuara në lidhje me qëllimet e hulumtimit, ku janë nxjerrë rekomandimet të cilat mund t'i shërbejnë kompanive të studiuar si edhe kompanive të tjera që kanë interes në këtë fushë.

Fjalë kyçe: marketing, konsumatorë, digjital, lojaliteti, reklamim, strategji

ABSTRACT

The consumer has already become the main mechanism that helps and ensures the functioning of any enterprise. Studying his behaviors is the key to successful profitability and producing the right products. In the modern era, in which we are living and which is characterized by a dynamic of development in all areas of life, it has been proven that creating customer satisfaction and loyalty is the key to the profit of any enterprise. Recently we are seeing very often talking or writing about companies that are using modern technology or companies "oriented towards digital marketing". These companies put the customer at the center of all their activities.

This paper will elaborate on the study of the effect of digital marketing on customer loyalty and the factors that influence the decision-making process for the purchase of modern digital consumers.

In this research, will be elaborated the study of the effect of the change of technological development on the behavior of digital consumers and the factors that influence the decision-making process for the purchase of digital consumers, respectively on the loyalty of consumers in Telekom and A1 companies.

In the first part of the paper, was made a review of the literature of various domestic and foreign authors, articles, scientific journals and their opinions about marketing and marketing strategies, various publications related to the meaning of the role and importance of marketing and marketing strategies related to enterprises. The review and summary from the analyzed literature have created a solid base which will serve as a reference point for the continuation in the practical part of the research.

In the second part of the paper, we talked about consumer behavior, customer relationship groups, factors in consumer behavior and consumer loyalty, which, with the aim of fulfilling their needs, directly affect the selection of the company they will stay with. faithful .

While, in the third part of the paper, a practical research was done through the survey questionnaire technique, where 230 consumers of the Telekom and A1 telephone companies were selected for the survey electronically. Through this research, it has been attempted to extract data to understand how loyal and satisfied consumers are with telephone companies.

At the end of the paper, from the data obtained from the survey questionnaires, certain

conclusions have been reached regarding the goals of the research, where recommendations have been drawn that can serve the studied companies as well as other companies that have an interest in this field.

Keywords: marketing, consumers, digital, loyalty, advertising, strategy

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I PARË

1. HYRJE	9
1.1. Hyrje e përgjithshme	9
1.2. Qëllimi i hulumtimit	11
1.3. Pyetjet hulumtuese dhe hipotezat.....	11
1.4. Rëndësia e punimit	11

KAPITULLI I DYTË

2. RISHIKIMI I LITERATURËS	12
2.1. Përkufizimi i marketingut digjital	12
2.2. Rëndësia e marketingut digjital	14
2.3. Avantazhet e marketingut digjital	16
2.4. Menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorët	18
2.5. Digjitalizimi në menaxhimin e marrëdhënieve me konsumatorët	19

KAPITULLI I TRETË

3. KUPTIMI I SJELLJES KONSUMATORE	24
3.1. Katër llojet e sjelljes në blerje të konsumatorëve	24
3.2. Procesi i vendimmarrjes së blerësit	27
3.3. Llojet kryesore të situatave të blerjes.....	30
3.4. Faktorët që ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve.....	33
3.5. Kënaqësia konsumatore dhe lojaliteti.....	40

KAPITULLI I KATËRT

4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	43
4.1. Përcaktimi i hipotezave	43
4.2. Zgjedhja e mostrës	43
4.3 Metoda e mbledhjes së të dhënave	44
4.4 Mënyra e përpunimit të të dhënave.....	44

KAPITULLI I PESTË

5. RASTI I STUDIMIT.....	45
5.1 Gjetjet dhe analiza e të dhënave.....	45
5.2 Rezultatet nga hulumtimi.....	46

5.3 Analiza e regresionit multivariabël.....	86
KAPITULLI I GJASHTË	
6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	91
6.1 Përfundime.....	91
6.2 Rekomandime.....	92
KAPITULLI I SHTATË	
7. LITERATURA E SHFRYTËZUAR.....	94

KAPITULLI I I . HYRJE

1.1 Hyrje e përgjithshme

Termi "marketing digjital" u përdor për herë të parë në vitet e 90-ta. Ndërmjet viteve 2000 dhe 2010, marketingu digjital u bë më i sofistikuar si një mënyrë efektive për të krijuar një marrëdhënie të thellë dhe të rëndësishme me konsumatorin. Përderisa termi "marketing digjital" nuk përdorej deri në vitet 1990, rrënjët e marketingut digjital filluan të zhvillohen në mesin e viteve 1980 kur Grupi SoftAd, tani ChannelNet, zhvilloi fushata reklamuese për disa kompani të mëdha automobilistike ku njerëzit do të dërgonin pyetje nga kartat e gjetura në revista dhe pranorin disqe "floppy" që përmbanin përmbajtje multimediale që nxisin promovimin e makinave të ndryshme dhe ofronin disqe testimi falas. Evolucioni i shpejtë i medias digjitale ka krijuar mundësi të reja dhe rrugë për reklamim dhe marketing.

Të nxitur nga përhapja e pajisjeve për të hyrë në mediat digjitale, kjo ka çuar në rritjen eksponenciale të reklamimit digjital. Në vitin 2012 dhe 2013 statistikatat treguan se marketingu digjital mbeti një fushë në rritje. Rritja e medias digjitale vlerësohet në 4.5 trilionë reklama online të shërbyera çdo vit me shpenzimet e medias digjitale me 48% rritje në vitin 2010. Një pjesë e reklamave në rritje rrjedh nga bizneset që përdorin reklamën Online Behavioral (OBA) për të reklamuar për përdoruesit e internetit. Edhe pse një burim inovativ, OBA ngre shqetësime në lidhje me privatësinë e konsumatorit dhe mbrojtjen e të dhënave. Këto implikime janë konsiderata të rëndësishme për komunikimet e përgjegjshme. Marketingu digjital shpesh quhet "marketing online", "internet marketing" ose "marketing internet". Termi "marketing digjital" është rritur në popullaritet me kalimin e kohës, veçanërisht në disa vende.

Në SHBA, për shembull, "marketingu në internet" është ende mbizotërues, dhe në Itali është referuar si "marketing web", por në Mbretërinë e Bashkuar dhe në mbarë botën, "marketing digjital" është bërë termi më i zakonshëm, veçanërisht pas vitit 2013. Teknologjitë digjitale po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në shumicën e sektorëve të aktivitetit ekonomik. Për shkak të niveleve të larta të inter konektivitetit, interneti është krahasuar me timonin dhe aeroplanin në aspektin e aftësisë së tij për të ndikuar në zhvillimin e ardhshëm të biznesit dhe shoqërisë. Rrjedhimisht, interneti ka dhënë shtysë për shumë kompani që të rishikojnë rolin e teknologjisë dhe dëshmitë tashmë tregojnë shtrirjen e ndikimit të saj global. Zhvillimi i hovshëm i

teknologjisë ka ndryshuar dukshëm kërkesat e audiencës. Një dekadë më parë mediat tradicionale ishin mjetet primare prej të cilave audiencia informohej. Sot, sipas studimit të Global WebIndex nga 7.396 miliardë banorë sa është popullsia e përgjithshme e botës, 3.419 miliard banorë apo 46% janë përdorues të internetit të cilët shfrytëzojnë mediat online për informim. Si rrjedhojë edhe marketingu po ndryshon formë, nga ai tradicional në atë digjital. Sipas studimit të PWC (një ndër katër kompanitë më të mëdha të auditimit në botë) kompanitë në vitin 2015 në marketing digjital kanë shpenzuar rreth 30% të buxhetit të marketingut, ndërsaq në vitin 2019 kjo shifër ka arritur në 46%. ¹Kjo nënkupton që marketingu digjital do të jetë forma kryesore e reklamimit, duke tejkaluar kështu për herë të parë marketingun në mediat tradicionale. Në vitin 1954 Peter Drucker, ka theksuar shumë qartë rolin e marketingut për suksesin e ndërmarrjes. Edhe në kohën e sotshme koncepti i tij mbi marketingun ka vlerën dhe qëndrueshmërinë e pakontestueshme:

“Nëse dëshirojmë të dimë se ç’është puna jonë, atëherë duhet të fillojmë me misionin... Ekziston vetëm një definicion i drejtë për misionin e ndërmarrjes: kënaqësia e konsumatorit. Ajo që ndërmarrja mendon të prodhojë nuk është e rëndësishë primare, veçanërisht jo për ardhmërinë dhe suksesin e saj. Vendimtare është ajo që konsumatori mendon të blejë përkatësisht ajo që për të paraqet vlerë, kjo përcakton çka është ndërmarrja e juaj, çka të prodhojë ajo dhe se a do të prosperoj ajo”

¹ <https://telegrafi.com/marketingu-digjital-marketingu-se-ardhmes-video/>

1.2 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit do jetë që të sigurohen informatat se:

1. Si të rritet numri i konsumatorëve të rinjë me anë të përdorimit të marketingut digjital;
2. Si të rritet lojaliteti i konsumatorëve ekzistues;
3. Si të rritet dhe përmirësohet reputacioni i kompanive “Telekom” dhe “A1” me anë të përdorimit të marketingut digjital;
4. Si të përmirësohet kultura dhe struktura organizative e kompanive në funksion të menaxhimit të lojalitetit të konsumatorëve në kompanitë Telekom dhe A1;
5. Si ndikojnë strategjitë e marketingut në rritjen e kënaqësisë së konsumatorit.

1.3 Pyetjet hulumtuese dhe hipotezat

Në këtë punim do të parashtrojmë pesë hipoteza të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për të definuar dhe arritur në përfundim për temën e sipërpërmendur. Hipotezat do të jenë:

- ✓ H1. Marketingu digjital ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- ✓ H2. Kënaqësia ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- ✓ H3. Cilësia e shërbimit ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- ✓ H4. Ankesat e shërbimit kanë ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- ✓ H5. Lojaliteti ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në WOM (fjalën e gojës).

1.4 Rëndësia e punimit

Punimi do të ketë rëndësi në fushën shkencore dhe praktike për menaxhimin e raportit ndërmjet kënaqësisë së konsumatorëve dhe rritjes së besnikërisë ndaj shërbimeve që ofrojnë

kompanitë e telekomunikimit. Të dhënat të cilat do të fitohen nga ky hulumtim, do të mund të iu ndihmojnë kompanive telefonike në vend që të kuptojnë rëndësinë që kanë shërbimet që ata ofrojnë në krijimin e kënaqësisë të konsumatorëve të tyre dhe të investojnë më shumë që të përmirësojnë shërbimet dhe të rrisin kënaqësinë tek konsumatorët, dhe t'i bëjnë lojal në kompanitë e tyre.

KAPITULLI II. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Përkufizimi i marketingut digjital

Marketingu digjital, i quajtur ndryshe edhe marketing online, është promovimi i markave për t'u lidhur me klientët potencialë duke përdorur internetin dhe forma të tjera të komunikimit digjital.² Kjo përfshin jo vetëm emailin, mediat sociale dhe reklamat e bazuara në ueb, por edhe mesazhet me tekst dhe multimedia si një kanal marketingu. Marketingu digjital dhe shërbimet elektronike konsiderohen si fushat më të reja të kërkimit të cilat paraqesin një rëndësi strategjike për bizneset që kanë drejtuar përpjekjet e tyre drejt tregut elektronik. Studimet kanë treguar se sjellja e konsumatorëve online ndryshon (në disa aspekte të rëndësishme) nga sjellja e konsumatorëve në tregun tradicional. Nga ana tjetër menaxherët duhet të kenë një kuptim të mirë të nevojave të konsumatorëve për ti përmbushur ato në mënyrë efektive dhe efëiente në mjedisin elektronik. Nëse specialisti i marketingut i njeh nevojat e konsumatorit, ai krijon produkte që sigurojnë vlerë superiore për konsumatorin, cakton çmime të shpërndan dhe i promovon produktet me efikasitet, këto produkte shiten lehtësisht (Kotler & Armstrong, 2013). Cilësia e shërbimeve elektronike është një koncept mjaft i diskutuar sidomos vitet e fundit. Ajo është përkufizuar si: “Shkalla në të cilën, një website lehtëson apo ndihmon procesin e blerjes (duke e bërë atë sa më efektiv dhe efëient) dhe shpërndarjen e produkteve apo shërbimeve”. Cilësia e shërbimeve elektronike është një tregues i fuqishëm i kënaqësisë konsumatore në website (Charlesworth, 2018).

Është pikërisht ajo që bën diferencën midis një website-i cilësor dhe një website-i jocalësor (nga këndvështrimi konsumator), që lehtëson procesin e afrimit të konsumatorëve me bizneset dhe ndikon në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve në afat të gjatë. Ideja e marketingut

² <https://getlead.page/sq/marketingu-dixhital/>

digjital dhe cilësia e shërbimeve elektronike përbën sfidën e biznesit në përgjithësi sot dhe në të ardhmen. Aktivitetet biznesore kanë pasur një zhvillim me ritme të shpejta sidomos gjatë dekadave të kaluara dhe u parashikua se marketingu online do të ishte aktiviteti bazë ekonomik në botë qysh nga viti 2000.

Për një kohë të shkurtër, marketingu në internet u bë një fenomen në të gjithë botën, duke e zhvendosur interesin e zhvillimeve të reja drejt tij. Një nga arsyet kryesore për rritjen e vëmendjes ndaj marketingut në internet është se ai përfaqëson tendencën e kohës. Nga ana tjetër duke parë përparimet në teknologji, aktivitetet e tij do të ndihmojnë ngritjen e bizneseve përmes promovimit online të produkteve dhe shërbimeve të tyre (Zeithaml, 2002).

Për shkak të niveleve të larta të inter konektivitetit, interneti është krahasuar me timonin dhe aeroplanin në aspektin e aftësisë së tij për të ndikuar në zhvillimin e ardhshëm të biznesit dhe shoqërisë. Interneti, rrjedhimisht, ka dhënë shumë kompani një nxitje për të rishikuar rolin e teknologjisë, dhe gjetjet tashmë tregojnë shtrirjen e ndikimit të saj global (Jobber&Ellis-Chadwick, 2013). Kanalet digjitale janë gjithashtu në gjendje të ofrojnë mënyra dhe mjete për të personalizuar përmbajtjen e medias, nëpërmjet përdorimit të kanaleve digjitale, konsumatorët janë në gjendje të krijojnë ose formësojnë formën e komunikimit në brez, siç është përcaktimi i kanalit të tyre dhe preferencës së përmbajtjes. Rrjedhimisht, teknologjia digjitale ndikon në modelet e biznesit, llojin e mjeteve të marketingut dhe medias që të gjitha agjencitë e komunikimit duhet të jenë në gjendje të japin. Prandaj, ka pasur një largim të madh nga mjetet e mëparshme të komunikimit tradicional dhe mediat dhe bizneset po kërkojnë mënyra në të cilat ofruesit e shërbimeve janë në gjendje të artikulojnë në mënyrë adekuate planet e tyre të marketingut digjital (Singh, 2011). Ky ndryshim në theks tregon se shitësit duhet t'i empatizojnë pritjet e konsumatorit dhe të dinë se si ata mund të përdorin teknologjinë për të arritur qëllimet e tyre të marketingut.

2.2 Rëndësia e marketingut digjital

Një arsye e mirë prapa rëndësisë së marketingut digjital është se është relativisht më pak e shtrenjtë se shumica e mënyrave të tjera të marketingut. Pandemia ka ndikuar në financat e të gjitha bizneseve dhe asnjë kompani nuk po hyn në vitin 2021 e padëmtuar. Pra, mënyrat e kursimit të kostos janë një përparësi kryesore për të gjitha bizneset. Marketingu digjital është fitimprurës sepse jep një ROI të lartë (kthim nga investimi) dhe ka shtrirjen e auditorit. Dhe, akoma për një buxhet modest, kompanitë mund të marrin një impuls mbi efektivitetin e strategjive të tyre të shitjes përmes metrikave të marketingut digjital. Strategjitë dhe fushatat e marketingut mund të ndryshohen pa një pengesë të konsiderueshme në buxhet.

Një arsye tjetër pas rëndësisë së marketingut digjital dhe pse nuk do ta tendosë buxhetin në 2021 është se ka aspekte të shumta të tij. Kompanitë do të përfitojnë nga një ekip profesionistësh të marketingut digjital sepse kanë një repertor të gjerë mjetesh për të tërhequr audiencën, të tilla si marketingu i përmbajtjes, banderola, marketingu me e-mail dhe siç kemi shpjeguar më herët, marketingu i mediave sociale. Pra, marketingu digjital do të jetë i rëndësishëm sepse paktohet në mënyra të shumta në një fushatë.

Zhvillimi i vazhdueshëm i marketingut digjital që nga vitet 1990 e deri më sot ka ndryshuar përdorimin e teknologjisë nga markat dhe bizneset dhe metodat e tyre të reklamimit. Ndërsa njerëzit priren të përdorin pajisje digjitale më shumë sesa një vizitë fizike në dyqane, marketingu digjital ishte bërë më efektiv për markat. Marketingu digjital është bërë një koncept i domosdoshëm pasi teknologjia është përhapur vitet e fundit (Chaffey, 2016). Për shembull, sipas Times of Oman (2018), përdoruesit e mediave sociale në Oman ishin rritur me mbi 600.000 që nga Janari 2007 për të qenë 2.60 milion përdorues deri në Janar 2018.

Prandaj, markat Omani gjithashtu kishin vazhduar me trendet dhe kishin përdorur marketing digjital për të vazhduar të tërheqin klientë të rinj pasi përdorimi i marketingut digjital ndihmon në përmirësimin e produkteve të tyre duke njohur nevojat dhe dëshirat e klientit përmes kanaleve të ndryshme digjitale (Chaffey, 2016).

Ekzistojnë disa lloje metodash që mund të përdoren për marketing digjital siç janë marketingu i motorëve të kërkimit, marketingu i ekranit, marketingu i mediave sociale, marketingu me ndikim dhe madje edhe lojërat online përmes aplikacioneve të smartphone. Në fakt, marketingu digjital po zgjerohet me shpejtësi në kanale jo-internet. Për shembull, SMS dhe

platforma në rrugë. Prandaj, markave iu desh të zhvillonin mënyra reklamimi për të ecur së bashku me tendencat e jetës. Shumë marka kishin përdorur gjithashtu ndikues të mediave sociale për të reklamuar produktin e tyre. Për shembull, restoranti Hot Chick i cili është një markë Omani kishte bashkëpunuar me blogeren e stilit të jetesës Omani Halima Alabdulsalam për reklamimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre përmes llogarive të saj në mediat sociale si Instagram dhe Snapchat (Shtojca A). Një shembull tjetër, aplikacioni Otaxi i cili është një aplikacion taksi sipas kërkesës Omani kishte përdorur marketingun e ekranit në Instagram në mënyrë që njerëzit të mund të rrëshqisin me lehtësi faqen e Instagram-it dhe të shkarkojnë aplikacionin. Prandaj, marketingu digjital ndihmon në ndërtimin e markës duke lejuar që marka të promovojë në disa lloje të ndryshme të kanaleve digjitale. Sa më shumë marka reklamojnë; aq më shumë reputacion fiton (Shirisha, 2018).

2.3 Avantazhet e marketingut digjital

Ndërveprimi me audiencën tuaj është e mundur me përdorimin e rrjeteve të mediave sociale. Në fakt, ndërveprimi inkurajohet. Metodatat tradicionale të marketingut nuk lejojnë ndërveprimin e audiencës. Ju mund të inkurajoni perspektivat tuaja, klientët dhe ndjekësit për të ndërmarrë veprime, për të vizituar faqen tuaj të internetit, për të lexuar produktet dhe shërbimet tuaja, për t'i vlerësuar ato, për të blerë ato dhe për të siguruar reagime që janë të dukshme në tregun tuaj. Marketingu digjital është me kosto efektive. Megjithatë disa investojnë në reklama të paguara online; megjithatë, kostoja është ende më e lirë krahasuar me marketingun tradicional (Cave, 2016).

Rrjetet sociale

Përdorimi i rrjeteve sociale është bërë bazë për komunikimin me miqtë, të afërmit tonë, por edhe informimi rreth artistëve që ne pëlqejmë. Rrjetet sociale përdoren për qëllime sociale dhe ato të biznesit. Me rritjen dhe fuqinë e rrjeteve sociale çdo individë mund të informohet për atë që dëshiron, por edhe mund të bëhet lajm ditor në kohë shumë të shkurtër. Gjithashtu edhe bota e të famshmëve e ka përdorur këtë mundësi të artë për të lansuar projektet e tyre të reja në këto rrjete dhe i lejon të lidhen me audiencën e tyre në nivel më të thellë. Përveç kësaj duke përdorur rrjetet sociale mund të ketë anët pozitive dhe negative. Artistët përdorin faqet e tyre sociale duke komunikuar me fansa dhe duke i bërë ata të ndjehen sikur njihen nga artistët, dhe kjo i bënë fansat të ndjehen më të rëndësishëm dhe i bënë të qëndrojnë më të kyçur gjithashtu dhe të sjellin anëtarë të rinj (Christman, 2011).

Facebook: Facebook është një komunitet i gjerë virtual i cili na mundëson ne si përdorues të ndajmë informacione dhe mendime të ndryshme mbi një zonë shumë të gjerë. Kjo na mundëson ne që të kemi një lidhje me ata të cilët kemi interesa të përbashkëta. Ky rrjet social nuk përdoret vetëm për argëtim por edhe për promovimin e bizneseve të ndryshme. Gjithashtu edhe të famshmit përdorin facebook si platformë për të promovuar projektet e tyre të reja, jetën private, komunikimin me fansa.

Instagram: Instagram u hap në tetor të vitit 2010, ai ka tërhequr më shumë se 150 milion përdorues aktivë të cilët kanë ngarkuar një mesatare prej 55 milionë fotografive në ditë (më shumë se 16 miliard foto deri në 2013). Instagram është një mënyrë e shpejtë dhe argëtuese për të ndarë me ndjekësit tanë fotot dhe videot. Gjithashtu ai përmban në vete edhe filtra të gatshëm

të cilët mund t'i bashkëngjiten fotos që ne do e postojmë. Instagram është bërë i suksesshëm që kur fotot dhe videot janë bërë monedh kryesore për të arritur suksesin e dëshiruar në rrjete sociale (Rainie, Brenner dhe Purcell, 2012). Të famshmit përdorin gjithashtu Instagram në masë të madhe, duke thënë se janë të kyçur 3 herë më shumë se brendet e ndryshme dhe mediat. Brendet duke bashkëpunuar me të famshmit kanë më shumë suksese në ekspozimin e markës, vetëdijes së imazhit.

Youtube: Që nga viti 2005 Youtube është bërë jashtëzakonisht popullore, qarkullojnë rreth 100 milionë video në ditë, duke filluar nga klipet disa sekondëshe e deri tek videot me më shumë se 10 minuta kohëzgjatje. Pra, përdoruesit mund të ngarkojnë videot e tyre në serverët e Youtube. Me përjashtim të materialeve ofenduese ose të paligjshme. Përmes një kanali që mund të krijohet si llogari në Youtube përdoruesit mund të ngarkojnë video të animuara, regjistrime private me miqtë por edhe bizneset e tyre. Nga fjalët kyçe, 11 kategoria, përshkrimi ose etiketimet mund të kërkohet video të cilën e kemi ngarkuar, por jo gjithmonë sepse video mund të jetë dhe private por edhe për një numër të caktuar të njerëzve. Edhe artisët përdorin Youtube në masë të madhe duke promovuar veprat e tyre, pastaj përmes shikimeve që marrin edhe paracaktohet suksesi i tyre, përdoruesit të cilët janë të regjistruar mund të pëlqejnë projektin përmes butonit (like) por mund edhe të komentojnë atë që e mendojnë. Përmes monetizimit Youtube mund të ngarkojë të ardhura në llogarinë e publikuesit.

Twitter: Twitter, një shërbim microblogging më pak se tre vjet, më shumë se 41 milion përdorues deri në korrik të vitit 2009 dhe është në rritje të shpejtë. Përdoruesit e Twitter mund të komentojnë në lidhje me ndonjë temë në kuadër të 140-karaktere të kufizuara dhe të ndjekin të tjerët për të marrë tweets e tyre. Një përdorues i Twitter mban një profil të shkurtër për veten. Profili përmban emrin e plotë, lokacionin, një faqe web, një biografi të shkurtër, dhe numri i tweets të përdoruesit. Njerëzit që ndjekin përdoruesit dhe ata që përdoruesi ndjek janë të listuara gjithashtu. Ashtu si shumë media sociale të tjera edhe twitter përmban përdoruesit e veçantë të cilët quhen të famshmit. Twitter krijon një "kontekst kolaps" (Boyd, 2008), në të cilën audienca mendohet si e veçantë, të cilët bashkë-ekzistojnë në një kontekst të vetëm shoqëror. Praktika e të famshmëve përfshinë këto audienca të shumta për të ruajtur me sukses fytyrën e tyre publike dhe për të menaxhuar përshtypjet që njerëzit kanë për ta.

Snapchat: Snapchat u lansua në vitin 2011 nga Evan Spiegel, Bobby Murphy dhe Reggie Brown, me qëllimin kryesor për të lehtësuar mesazhet kalimtare dhe ndarjen e përmbajtjes në një mënyrë më të rastësishme dhe private. Ajo që fillimisht filloi si një platformë për ndarjen e fotografive u zgjerua shpejt duke përfshirë video, histori, filtra dhe lente të realitetit të shtuar (AR), duke u ofruar përdoruesve një gamë të larmishme mjetesh për vetë-shprehje dhe kreativitet. Një nga veçoritë e spikatura të Snapchat është natyra e tij kalimtare. Duke i lejuar përdoruesit të dërgojnë mesazhe dhe të ndajnë përmbajtjen që zhduket pasi të shikohet, Snapchat prezantoi një mënyrë të re komunikimi që theksoi privatësinë dhe vërtetësinë. Ky aspekt kalimtar i Snapchat jo vetëm që siguroi një ndjenjë lirie, por gjithashtu adresoi shqetësimet rreth gjurmëve dixhitale dhe privatësisë që lidhen me platformat tradicionale të mediave sociale. Evoluimi i tij nga një aplikacion i thjeshtë për ndarjen e fotografive në një platformë gjithëpërfshirëse multimediale, shoqëruar me veçori inovative dhe integrimin AR, ka vendosur standarde të reja në industri. Duke nxitur autenticitetin, kreativitetin dhe intimitetin, Snapchat ka tërhequr vëmendjen e miliona njerëzve në mbarë botën, duke ndikuar në mënyrën se si ne komunikojmë, ndajmë përvojat dhe shprehemi në epokën digjitale.

2.4 Menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorët

Orientimi drejt konsumatorit njihet edhe si koncepti i marketingut dhe është këndvështrimi afarist që nga tri-katër dekadat e fundit, atëherë kur departamenti i marketingut gjenë vendin e tij në strukturën organizative të ndërmarrjes, madje ndonjëherë kemi edhe një mbivlerësim të tij. Tashmë pozicioni i departamentit të marketingut është njësoj, madje edhe më i privilegjuar në raport me departamentet tjera brenda për brenda ndërmarrjes. Koncepti i marketingut, pikën nismëtare e gjenë në nevojat dhe dëshirat e konsumatorit me qëllim që të ofrohen produkte a shërbime që do t'i plotësojnë ato në treg më mirë se konkurrentët tjerë. Pra, nga një qëndrim pasiv ndaj konsumatorit dhe imponimit të produkteve, marketingu përpiqet për një qëndrim aktiv ndaj tyre duke hulumtuar vazhdueshëm nevojat, dëshirat dhe kërkesat e konsumatorëve e duke ua përshtatur produktet dhe shërbimet atyre më mirë se konkurrenca në treg. Kjo filozofi afariste nuk ka lindë rastësisht, por është pasojë e raporteve të mjedisit afarist të ndërmarrjes në fazën e caktuar të zhvillimit të secilës ekonomi të tregut.

Konsumatorët e sotshëm është vështirë të kënaqën, janë më të mençur, me të vetëdijshëm për çmim, kërkojnë më shumë, harrojnë vështirë, dhe i ofrohen shumë konkurrent tjerë me oferta

të njëjta ose më të mira. Sfida, sipas Jeffrey Gitomer, nuk është që të krijohen konsumatorë të kënaqur; disa kompani mund ta bëjnë këtë. Sfida është që të prodhohen konsumatorë besnik dhe të mahnitur. Kompanitë që kërkojnë të zgjerojnë profitin dhe shitjet e tyre duhet të shpenzojnë kohë dhe resurse të konsiderueshme që të kërkojnë konsumatorë të ri. Për të gjeneruar lidhje, kompania zhvillon reklama dhe i vendos ato në media që do të arrijnë prospekte të reja; dërgon postë drejtpërdrejt ose bën telefonata për prospektet e rinj të mundshëm; punëtorët e shitjes marrin pjesë në prezantimet tregtare ku mund të gjejnë lidhje të reja; dhe kështu me radhë, i gjithë ky aktivitet prodhon një listë të “dyshimtëve”. Detyra tjetër është të identifikohen se cilët të dyshimtë janë në të vërtetë prospekt të mirë, duke i intervistuar, duke kontrolluar gjendjen e tyre financiare, e kështu me radhë. Pastaj vjen koha për të dërguar punëtorët e shitjes.

2.5 Digjitalizimi në menaxhimin e mardhënieve me konsumatorët

Në këtë epokë digjitale, interneti është shtylla kurrizore e çdo komunikimi. Në këtë kontekst, CRM zakonisht përcaktohet si përdorimi i kanaleve dhe teknologjive të komunikimit në internet për të ofruar një përvojë të përmirësuar të klientit, si dhe nismat e menaxhimit të përvojës së klientit (CEM). CRM nuk synon vetëm t'i sigurojë një organizatë një analizë të qartë dhe të detajuar të zakoneve dhe preferencave të secilit klient, por gjithashtu ndihmon që personalizimi dhe mesazhet e automatizuara të jenë më të buta dhe efikase.

Lidhja e CRM me Internetin e Gjërave (IoT) është e zakonshme. IoT krijon situata kur klienti mund të mos jetë gjithmonë njeri, dhe mund të jetë gjithashtu një objekt në vend të tij. Një CRM e pajisur në mënyrë digjitale është në gjendje të merret me situata të tilla me lehtësi dhe i përcjell informacionet e kërkuara klientit të duhur pa mundim dhe në një hark të shkurtër kohor.

Në jetën e përditshme jemi të ballafaquar me një konsumim të pa shembull të teknologjisë. Kjo na mundëson që të afektohem pothuaj se në të gjitha segmentet e jetës. Ndodhë që për një moment përmes kësaj teknologjie të na përkujtojnë një nevojë të cilën e kemi tejkaluar për shkak të dinamikës së jetës dhe vendosim që ta blejmë.

Esenca e kësaj është se si afekton reklamimin në masë, e cila në asnjë formë tjetër të komunikimit deri tash nuk është arritur. Pra, sot, lirshëm mundemi të themi se është e pamundur të kihet një afarizëm i suksesshëm në tregun global apo edhe në nivelin lokal edhe shtetëror, pra të pretendosh që të jesh konkurrent e që në afarizmin tuaj mos të ketë implementim të

teknologjisë sikurse është interneti është pothuajse në rrethanat e tanishme e pamundur apo të paktën nuk është e njohur në teoritë moderne të marketingut. Si segment i drejtpërdrejtë i marketingut i cili ka njohur rritjen më të madhe, është marketingu online i cili u mundëson kompanive një ndikim të madh në sjelljen e konsumatorit, prandaj edhe kompanitë e kanë kuptuar se duhet qasje e veçantë e këtij segmenti mediatik, i cili mund të shfrytëzohet edhe pa kosto shtesë të reklamimit.

Blerjet online mundësojnë që blerësi të jetë më efektiv sepse i mundësohet një qasje më e madhe në vlerësimin e kualitetit, mundësohet qasje në një asortiment më të madh nga vendi i tij i jetës apo punës së konsumatorit, mund të ofrohet me çmime më të volitshme dhe e gjithë kjo duke mos pas nevojë të shëtis përgjatë tregjeve të ndryshme pra duke e kursyer kohën. Kjo formë e shit-blerjes online në njërën anë do të bjer zhvillim të përgjithshëm, rritjen e kërkesës për të mira materiale, kursim të kohës dhe të parasë, dhe në anën tjetër do ta dëmtoi formën tradicionale të tregtimit dhe detyrimisht do të ketë një impakt të konsiderueshëm edhe në numrin e të punësuarve të ndërmjetësve në shit-blerje.

Nëse do të ketë tendencë apo hezitim të kyçjes në këtë formë të tregtimit, kompanitë me këtë tendencë të tilla do të jenë jo konkurruese në treg dhe kjo detyrimisht do të reflektohet edhe në mundësinë e ekzistencës apo rezistencës së tyre në treg. Ndikim shumë të madh, interneti ka veçanërisht tek kompanitë e vogla të cilat e kanë ndryshuar në të madhe natyrën e tregtimit të tyre.

Do ti theksoja katër shkaqet të cilat interneti i mundëson kompanive të vogla që të transformohen në kompani të suksesshme. Rritja e efikasitetit të marketingut e cila tenton që të gjitha tregjet t'i bëjë më efikas duke i ndërlidhur dhe mundësuar që të bëjnë shkëmbime mallrash. Në internet askush nuk e di se ju jeni një biznes i vogël.

Ndryshim i natyrës së blerjes. Ndryshimi në krijim dhe gjetjen e informatave. Sa do të kishte mundësi një kompani e vogël të plasoi produktet e veta në nivel global po që se nuk do të kishte mundësi që produktet e veta ti reklamon në një hapësirë shumë të gjerë. Interneti e mundëson një reklamim të tillë me një kosto shumë të lirë dhe me një shtrirje shumë të gjerë duke mos e ndjer inferioritetin të jesh kompani e vogël. Arsyet e ndoshta një rritjeje më të ngadaltë apo hezitimi të kësaj forme të tregtimit është rrezikshmëria të cilën e bartin në vetvete, kjo formë e blerjes e cila ndryshe është emërtuar edhe si “Blerje nga fotelja” e veçanërisht rrezikshmëria se a do ta merrni produktin e paguar. Si rreziqe të vërejtura janë web adresat e

kompanive inekzistente, rreziku i marrjes së të dhënave bankare dhe keqpërdorimi i tyre, prandaj është e udhëzuar që paraprakisht të verifikohen se kush është mbas ndonjë sajti i cili bënë ofertë, porosia të bëhet nga persona juridik sepse është më lehtë të verifikohen dhe njëkohësisht të reagohet në rastet kur produkti i marrë nuk i përgjigjet produktit të kërkuar (Suki, 2013).

Për të pasur një siguri në një kompani shitjeje përmes interneti ajo kompani së paku duhet ti ketë të prezantuara këto elemente; detajet e plota mbi produktet dhe ofertat, çmimet qartë të përcaktuara, të dhënat mbi mënyrën e pagesës, të dhënat themelore të shitësit dhe të dhënat e kontaktit dhe të dhënat mbi të drejtat e konsumatorit.

Prandaj fokusi i njerëzve të marketingut është që të krijohet një qasje inovative për të kuptuar sjelljen e konsumatorit veçanërisht në kohën e tregtive dinamike kur nuanca shumë të vogla janë përcaktuese të sjelljeve të konsumatorit karshi produkteve të cilat plasohen në treg. Për tu kuptuar kjo sjellje është e nevojshme një qasje jo klasike veçanërisht në periudhën e vërshimit të tregut nga prodhimet e reja dhe po që se nuk kuptohet saktë sjellja e konsumatorit atëherë vështirë se do të mund të mbijetonin ato subjekte ekonomike të cilat e fillojnë veprimtarin e tyre me produkte të reja. Për të pasur një pasqyrë të faktorëve të cilët ndikojnë në suksesin apo mosesuksesin e plasimit në treg të një produkti është e domosdoshme që në mënyrë analitike të vlerësohen faktorët të cilët ndikojnë së pari në mos suksesin e një produkti e ato sipas studimeve janë:

- Vlerësimi i madhësisë së tregut
- Dizajni i dobët i produktit
- Pozicionimi i gabuar i produktit
- Çmimi i lartë
- Informimi i pamjaftueshëm mbi produktin
- Nënvlërësimi i rezultateve të hulumtimeve
- Kostoja e madhe e zhvillimit të produktit
- Reagimi i shpejtë i konkurrencës

Menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorin (CRM) ka evoluar ndjeshëm vitet e fundit, i nxitur nga përparimet në teknologji dhe ndryshimi i pritjeve të konsumatorëve. Sot, CRM është më shumë se thjesht një sistem softuerësh; është një qasje gjithëpërfshirëse për të kuptuar dhe për t'u

angazhuar me konsumatorët për të nxitur rritjen e biznesit dhe besnikërinë e konsumatorit. Softueri CRM luan një rol jetik në zbatimin e strategjive CRM. Ai u ofron kompanive një platformë të centralizuar për të ruajtur të dhënat e konsumatorëve, për të ndjekur ndërveprimet dhe për të menaxhuar marrëdhëniet me konsumatorët në mënyrë efektive. Sistemet moderne CRM shpesh përdorin teknologji të avancuara si inteligjenca artificiale (AI), mësimi i makinerive dhe automatizimi për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe për të përmirësuar proceset (Buttle, 2020).

Një nga tendencat kryesore në CRM është integrimi i teknologjive të inteligjencës artificiale (AI) dhe të mëimit të makinerive (ML). Sistemet CRM të fuqizuara nga AI mund të analizojnë vëllime të mëdha të të dhënave të konsumatorit dhe të ofrojnë njohuri të vlefshme për sjelljen, preferencat dhe tendencat e konsumatorëve. Këto njohuri i ndihmojnë bizneset të personalizojnë mesazhet e tyre të marketingut, të përshtatin ofertat e produkteve të tyre dhe të ofrojnë përvoja të jashtëzakonshme të konsumatorit. Sipas një raporti nga Grand View Research, tregu global i CRM i fuqizuar nga AI pritet të arrijë në 81.9 miliardë dollarë deri në vitin 2025 (Grand View Research, 2020).

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm në CRM është përqëndrimi në rritje në angazhimin e konsumatorëve të gjithë kanalit. Konsumatorët tani presin një përvojë të qetë në kanale të shumta, duke përfshirë faqet e internetit, mediat sociale, emailin dhe aplikacionet celulare. Sistemet moderne CRM u mundësojnë organizatave të centralizojnë të dhënat e konsumatorëve nga pika të ndryshme kontakti dhe të ofrojnë një përvojë të qëndrueshme dhe të personalizuar nëpër kanale. Sipas një sondazhi nga Salesforce, 80% e klientëve thonë se përvoja që ofron një kompani është po aq e rëndësishme sa produktet dhe shërbimet e saj (Salesforce, 2020).

Mobile CRM gjithashtu ka fituar tërheqje të konsiderueshme vitet e fundit. Me përdorimin e gjerë të telefonave inteligjentë dhe tabletëve, ekipet e shitjeve mund të kenë akses në informacionin e klientit, të gjurmojnë aktivitetet dhe të përditësojnë të dhënat ndërsa janë në lëvizje. Zgjidhjet CRM celulare fuqizojnë përfaqësuesit e shitjeve që të jenë më produktivë dhe të përgjegjshëm, duke çuar në ndërveprime të përmirësuara me klientët dhe performancë më të mirë të shitjeve. Një studim nga Nucleus Research zbuloi se aplikacionet CRM celular mund të rrisin produktivitetin me 14.6% për shitësit (Nucleus Research, 2020).

Përveç përparimeve teknologjike, CRM ka parë gjithashtu një zhvendosje drejt strategjive të përqëndruara te klientët. Organizatat po i kushtojnë më shumë rëndësi të kuptuarit të nevojave të klientëve, preferencave dhe pikave të dhimbjes për të ofruar përvoja të personalizuar dhe përkatëse. Kjo qasje e përqëndruar te klienti përfshin mbledhjen e reagimeve të klientëve, kryerjen e sondazheve dhe shfrytëzimin e mjeteve të dëgjimit të mediave sociale për të fituar njohuri për ndjenjat dhe preferencat e klientëve. Një studim nga Deloitte zbuloi se kompanitë me aftësi të forta të përqëndruara te klientët janë 60% më fitimprurëse krahasuar me konkurrentët e tyre (Deloitte, 2020).

Për më tepër, sistemet CRM po integrohen gjithnjë e më shumë me sistemet e tjera të biznesit për të ofruar një pamje tërësore të klientit. Integrimi me platformat e automatizimit të marketingut, sistemet e tregtisë elektronike dhe softuerin e shërbimit ndaj klientit i lejon organizatat të thjeshtojnë proceset, të automatizojnë detyrat dhe të ofrojnë një udhëtim të pandërprerë të klientit. Sipas një raporti nga Gartner, deri në vitin 2022, 70% e ndërveprimeve me klientët do të përfshijnë teknologjitë në zhvillim, të tilla si chatbots dhe asistentë virtualë, të integruara me sistemet CRM (Gartner, 2020).

Si përfundim, CRM ka evoluar në një disiplinë strategjike që përdor teknologjinë, të dhënat dhe njohuritë e klientëve për të nxitur suksesin e biznesit. Me përparimet në AI, angazhimin e të gjithë kanaleve, aftësitë celulare, strategjitë me në qendër klientin dhe integrimin e sistemit, CRM është bërë një mjet kritik për organizatat për të ndërtuar marrëdhënie të forta me klientët dhe për të fituar një avantazh konkurrues në peisazhin e sotëm digjital.

KAPITULLI III. KUPTIMI I SJELLES KONSUMATORE

3.1 Katër llojet e sjelljes në blerje të konsumatorëve

Sjellja e konsumatorit është një fushë komplekse dhe dinamike studimi që synon të kuptojë veprimet, vendimet dhe sjelljet e shfaqura nga individë ose grupe individësh në procesin e përzgjedhjes, blerjes, përdorimit dhe asgjësimit të produkteve, shërbimeve, ideve ose përvojave për të kënaqur nevojat dhe dëshirat e tyre (Solomon, M.R. 2021). Duke analizuar faktorë të ndryshëm që ndikojnë në zgjedhjet e konsumatorëve, studiuesit dhe tregtarët mund të fitojnë njohuri mbi preferencat, motivimet dhe proceset e vendimmarrjes së konsumatorëve. Konsumatorët nuk brengosen për mënyrën se si marketerët definojnë gjërat ngase ata janë të interesuar për përvojën, sa u mundëson marketingu atyre për ta rrit përvojën dhe si i ndihmon ata për të qenë sa më të informuar para marrjes së vendimeve. Njerëzit janë elementi më i rëndësishëm në çdo formë të marketingut. Kjo është po aq e vërtetë edhe në hapësirën digjitale, siç është në çdo sferë tjetër të marketingut. Sjellja e konsumatorëve po ndryshon për shkak mundësive që po ofron marketingu digjital, ku pjesa më e madhe e konsumatorëve sot përdorin internetin, si pjesë të përditshmërisë së tyre.

Marketerët duhet të kuptojnë njerëzit dhe sjelljen e tyre, ndryshimet e shpejta që po sjellë natyra e hapur e zhvillimeve teknologjike (Ryan and Calvin Jones, 2009). Sot kompanitë mendojnë që ata i njohin konsumatorët por ata nuk i njohin konsumatorët më, nga sa e sa hulumtime të kryera nuk kanë arritur të ilustrojnë një fotografi të konsumatorit modern. Pse? Sepse konsumatori është duke evoluar më shpejt sesa kompanitë (Eric Greenbergand & Alexander Kate, 2013).

Bota në të cilën jetojmë sot iu mundëson konsumatorëve qasje dhe informacione pa pagesë kudo që janë, që do të thotë se konsumatorët vazhdimisht janë një hap përpara. Ata e dinë se cilat janë produktet dhe shërbimet më të mira dhe bëjnë vazhdimisht krahasime. Me t'u shfaqur teknologjia dhe pajisjet e reja në treg, konsumatorët po fillojnë t'i përdorin brenda ditës përderisa kompanive një vendim i tillë iu merr muaj të tërë mbase edhe vite duke pritur për propozime projekti, aprovime menaxheriale dhe pajtime mes partnerëve, kjo është ajo që i bënë konsumatorët të jenë vazhdimisht më përpara (Eric Greenberg & Alexander Kate, 2013). Treni

digjital tani vetëm se është në stacion dhe marketerët duhet të vrapojnë ta zënë atë, përndryshe konkurrentët i zënë vendet dhe të lënë jashtë.

Faktorët kyç të performancës;

Performanca në përgjithësi nënkupton realizimin e një apo më shumë detyrave, aktiviteteve, veprimeve (operacioneve) të caktuara kundrejt standardeve paraprkisht të njohura të saktësisë, kualitetit, kostos, dhe shpejtësisë.

Definimi i performancës për biznes;

Performanca në biznes nënkupton realizimin e qëllimeve dhe objektivave të biznesit në mënyrë të pavarur. Që biznesi të ketë dalje të kënaqshme dhe të ketë një performancë të mirë, patjetër që duhet të realizoj aktivitete të shumta të ndërlidhura dhe të varura. Aktivitetet e tilla janë operacionet të cilat së bashku krijojnë proceset transformuese (Limani, 216). Çka është performanca e biznesit?

Performanca e operacioneve në biznes apo organizatë nënkupton realizimin dhe matjen e aktiviteteve biznesore të organizatave të parapara apo të planifikuara të organizatës/biznesit në mënyrë efektive dhe efçiente. Performanca e mirë është qëllim i çdo individi dhe çdo organizate. Që të arrihet ky qëllim, bizneset duhet plotësuar pesë objektiva themelore. Objektivat janë rrugët apo mënyrat se si biznesi apo organizata do të arrijë qëllimin e përcaktuar, në këtë rast performancën e mirë. Pesë objektivat e menaxhmentit të organizatës për të arritur performancën e dëshiruar në biznes apo organizatë janë: kualiteti, shpejtësia, besueshmëria, fleksibiliteti, dhe kosto. Matësit apo faktorët matës të performancës na tregojnë nëse janë arritur objektivat e performancës. Performanca e operacioneve të organizatës matet kundrejt standardeve ose tregueseve/indikatorëve të caktuar të:

- Produktivitetit, efektivitetit, efçiençës
- Përgjegjësiive sociale (shëndeti i njeriut, kualiteti i jetës, shkalla e rrezikshmërisë, siguria, etj.)
- Përgjegjësiive ndaj mjedisit: reduktimi i mbetjeve dhe humbjeve, kualiteti i ajrit, ujit dhe tokës, ndotja nga zhurma, përdorimi dhe krijimi i energjisë, etj.
- Ekonomisë: produktiviteti, prodhimi, shitja, tregu, koha e ciklit të zhvillimit apo e ciklit jetësor të produktit, hyrjet, daljet, etj.

- Aplikimit të pakusht të standardeve dhe rregulloreve përkatëse (Limani, 2016). Uglă (2011), përcakton dy tipe të sjelljes konsumatore, duke i ndarë në orientimin njohës dhe eksperiencën njohëse. Konsumatorët, të cilët bazohen në orientimin njohës, janë konsumatorë racional dhe logjik, kurse konsumatorët, të cilët bazohen në eksperiencën njohëse, kanë më shumë motive emocionale për blerjen e një produkti.

Kurse Dalvist dhe Linde (2002), kanë përkufizuar katër tipe të sjelljes konsumatore; atë racionale, të pavullnetshme, të mësuar dhe atë shoqërore. Këto sjellje janë të orientuara nga renditja e tri hapave të cilët janë: dija, qëndrimi dhe veprimi.

1. **Sjellja racionale.** Nëse konsumatorët kanë një sjellje racionale, ata fillimisht marrin dije rreth produktit dhe atë se çfarë mund të ofrojë tregu. Duke vlerësuar informacionin ata krijojnë një qëndrim rreth produktit dhe më tej veprojnë duke e blerë ose jo produktin. Kjo sjellje është më e vërejtur te blerjet e shtrenjta (dije-qëndrim-veprim).
2. **Sjellja e pavullnetshme.** Kur konsumatorët kanë një sjellje të pavullnetshme, ata fillojnë me një qëndrim rreth produktit dhe qëndrimi u lind nga emocionet dhe ndjenjat. Në qëndrimet e tyre, konsumatorët kërkojnë informacion rreth produktit dhe nga kjo ata marrin informacion dhe njohuri, ndërsa në fund veprojnë me zgjedhjen e tyre. Kjo sjellje është e hasur në periudha kur duhet të votojnë (qëndrim-dije-veprim).
3. **Sjellja e mësuar.** Reflektet vendosin në zgjedhjen e produktit, kur konsumatorët e zgjedhin një produkt, ata nuk e planifikojnë zgjedhjen e tyre, ata e bëjnë këtë nga zakoni. Kjo sjellje haset kur konsumatorët blejnë gazeta (veprim-dije-qëndrim).
4. **Sjellja shoqërore.** Sjellja shoqërore ndodh, kur konsumatorët e zgjedhin një produkt në varësi të zhvillimit shoqëror që ata jetojnë, stilit të tyre të jetës, statusit dhe influencës së të tjerëve për të vendosur se çfarë produkti do të zgjedhin (veprim-qëndrim-dije).

3.2 Procesi i vendimmarrjes së blerësit

Procesi i marrjes së vendimit dhe rezultatet e sjelljes janë studiuar për të sjellë parashikim dhe ndryshim (Ozanne, Hudson, 1989). Procesi i marrjes së vendimit për blerje paraqet një mori sekuecash ndikuese dhe vendimeve të cilat rezultojnë me veprimin e dëshiruar. Që procesi i vendim marrjes në realitet ti afrohet individit, janë krijuar modele të sjelljes së konsumatorëve të cilët kanë pasur për qëllim ti tregojnë variablat të cilat ndikojnë në arritjen e vendimit mbi blerjen dhe lidhshmërin e tyre ndërmjet veti. Ndërlikushmëria e modelit ka varirur nga një autor tek tjetri mirëpo modelet e ndërlikuara në esencë dallojnë në atë se a bëhet fjalë për blerjen e parë apo blerjen rutinë. Dallimi nuk ekziston në numrin e pjesmarrësve dhe fazave nëpër të cilat kalon konsumatori por nga niveli i përfshirjes psikike dhe kohës të cilën ja kushton analizës së fazave të caktuara. Modeli kompleks i selljes së konsumatorit gjatë vendimmarrjes mund të vështrohet në kuadër të këtyre nënproceseve.

- Njohja mbi nevojat është faza fillestare e çdo procesi të vendimmarrjes.

Ekzistojnë tri determinante të njohjes mbi nevojën; informatat e memorizuara, dallueshmëria e individëve dhe ndikimi i rrethit. Njohja mbi nevojën e një produkti të ri apo veç të njohur mund të lajmërohet si rezultat i aktivitetit reklamues në treg apo si nevojë e ndryshimit.

- Kërkimi i informatave është faza e radhës në procesin e vendimmarrjes, është hulumtimi i brendshëm mbi nevojat aktuale që të kalojmë në fazën e vendimmarrjes dhe nëse ato nuk janë të mjaftueshme atëherë kalojmë në kërkimet e informatave të jashtme të cilat na lehtësojnë vendimmarrjen dhe këtu rrol të rëndësishëm luan komunikimi me marketingun në fazën e njohjes së produktit dhe krijimit të një imazhi të dëshiruar tek konsumatori.

- Përpunimi i informatave për se sa gjatë dhe me ç'farë kujdesi konsumatori do ti përcjell dhe do t'i pranoi informatat varet prej shumë faktorëve por në masë të madhe varet nga përfshirja psikologjike në procesin e komunikimit dhe njohurive paraprake.

- Vlerësimi i alternativave zhvillohet përmes kriterëve vlerësues të cilat janë pjesë përbërëse e individit. Kriteret vlerësuese paraqesin standarde dhe specifikime të shfrytëzuara nga konsumatori si pika referuese për krahasimin e produkteve dhe markave të ndryshme.

- Blerja dhe proceset pas blerjes paraqesin fazën e fundit të procesit të blerjes. Blerja paraqet fazën juridike të kalimit të produktit tek blerësi. Mirëpo edhe në këtë fazë ekziston dallimi në mes të blerjes rutinë dhe të blerjes për zgjidhjen e problemit. Në fazën pas blerjes zakonisht vije

deri te procesi i vlerësimit të produktit. Ky është proces i kyçjes aktive në të cilën blerësi vlerëson përpunon të përzgjedhurën karshi të gjitha opsioneve të ofruara.

Sot, konsumatori, është përballë shumë alternativave zgjedhjeje të produkteve dhe njësive të shitjes në blerjen e produkteve të konsumit. Atij i duhet të zgjedhë produktet të së njëjtës kategori, por të markave të ndryshme, qofshin vendase apo të huaja në qendra tregtare, supermarkete, markete apo njësi të vogla shitjeje të produkteve të konsumit. Për çdo kategori të produktit, që konsumatori do të bëjë zgjedhje, këto produkte janë të madhësive, ngjyrave, stileve, modeleve dhe markave të ndryshme të vendit dhe të huaja. Përveç kësaj, konsumatori është përballë informacionit të medimeve elektronike dhe të shkruara, në lidhje me informacionet mbi prodhimet e markave të falsifikuara, produkteve të skaduara, që tregtohen në treg. Kur bëhet fjalë për produkte ushqimore, ky informacion është shumë i rëndësishëm në vendimmarrje, sepse zgjedhja e produkteve dhe markave ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe në organizmin e tyre dhe të familjarëve. Procesi i vendimmarrjes për zgjedhjen e markave të produkteve dhe besueshmërisë së njësive të shitjes, që i tregtojnë ato, është shumë i rëndësishëm dhe jetik. Prandaj, është e domosdoshme, që të lexohet i gjithë informacioni në etiketë dhe të kryhet vëzhgimi fizik mbi produktin, në mënyrë që konsumatorët të bëjnë një zgjedhje sa më të shëndetshme për veten dhe familjen. Procesi i vendimmarrjes është studiuar nga shumë autorë të fushës së sjelljes konsumatore dhe marketingut. Fillesat e studimit të këtij procesi janë kryer nga Engel, Kollat dhe Blackwell, duke hedhur kështu themelet e këtij procesi në ndërtimin e modelit të quajtur modeli (EKB), i cili është paraqitur për herë të parë në vitin 1960 (Blythe 2006). Një rëndësi e veçantë në procesin e vendimmarrjes së konsumatorit, i është kushtuar edhe zgjedhjes së njësisë së shitjes së produkteve. Bazuar në vlerësimin e fazave të vendimmarrjes nga Engel, Blackwell & Miniard (1987), modeli ndryshon, kur studiohen proceset e vendimmarrjes së konsumatorëve.

Dy aspektet kryesore janë kriteret e përgjithshme (si vendodhja, distanca, zgjedhja e produkteve, çmimet, publiciteti, promocioni, stafi dhe shërbimi) nga njëra anë dhe karakteristikat të tjera të perceptuara si “imazhi i duhur i dyqanit” i vlerësuar nga klientët, nga ana tjetër. Gjykimi se sa të pranueshëm ose të papranueshme janë këta faktorë është tjetër gjë, por që të gjithë duhen marrë në konsideratë. Lehota, Horvath dhe Gyenge (2006) në punimin e tyre theksojnë se, në modelin e zgjedhjes së konsumatorit në njësitë e shitjes nga Heinemann (1974), përshkruhen pesë hapa të dallueshme, duke analizuar procesin e vendimmarrjes përmes zgjedhjes së njësisë së shitjes.

Hapat përfshijnë identifikimin e arsyeve të blerjes, kërkimin e alternativave, vlerësimin e alternativave, zgjedhjen e njësisë me pakicë dhe vlerësimin e zgjedhjeve. Tietz (1993) e konsideron zgjedhjen në njësinë e shitjes me pakicë, si një proces tri dimensional të vendimmarrjes. Konsumatori vlerëson dhe zgjedh produktet (markat) dhe llojin e njësisë së shitjes me pakicë dhe pastaj përfundon në zgjedhjen e njësisë më optimale të blerjes. Kështu zgjedhja e produktit, e llojit të njësisë së shitjes dhe e njësisë së blerjes janë të lidhura me karakteristikat cilësore dhe sasiore të konsumatorit. Hawkins, Best & Coney (1986) në modelin e tyre tregojnë, se fazat e identifikimit të problemit, kërkimit të informacionit dhe vlerësimit të alternativave, ndiqen nga vendimmarrja. Megjithatë, kjo vendimmarrje përfshin jo vetëm zgjedhjen e produktit, por edhe zgjedhjen e njësisë së shitjes. Më vonë në literaturë është përfshirë dhe hapi i pestë, ai i sjelljes pas blerjes. Sipas Harris (1998), vendimmarrja është studimi i identifikimit dhe zgjedhjes së alternativave, të bazuara në vlerat dhe preferencat e vendimmarrësit.

Marrja e një vendimi nënkupton se do të merren në konsideratë disa alternativa zgjedhjeje dhe në një rast të tillë, konsumatorët, jo vetëm duan ta identifikojnë sa më shumë të jetë e mundur prej këtyre alternativave, por edhe ta zgjedhin atë që i përshtatet më mirë qëllimeve, objektivave, dëshirave dhe vlerave të tyre. Sipas Keller (2002), konsumatorët ndjekin sekuencat e hapave në procesin e vendimmarrjes për të blerë një produkt specifik, duke filluar me lindjen e një kërkese për produktin, marrjen e informacionit, identifikimin dhe vlerësimin e alternativave rreth produkteve dhe në fund vendosin për të blerë një produkt të një marke të caktuar ndërmjet markave të marra si alternativa. Kur konsumatorët e blejnë shpesh një markë të caktuar, ata përdorin përvojën e tyre të kaluar në lidhje me atë produkt të markuar, duke pasur parasysh performancën, cilësinë dhe pamjen e jashtme. Sipas Richarme (2005), në procesin e zgjedhjes, konsumatorin e ndjekin dy teori marketingu.

Teoria e parë e marketingut është quajtur vëmendja. Sipas kësaj teorie, konsumatorët marrin në konsideratë një sërë markash nga ku zbatohen strategjitë vendimmarrëse për zgjedhjen e këtyre markave. Teoria e dytë e marketingut quhet përfshirja, në të cilin përpjekjet njohëse të aplikuara në procesin e vendimmarrjes lidhen drejtpërdrejtë me nivelin e rëndësisë, që konsumatori merr në konsideratë mbi blerjen e një produkti të veçantë. Konsumatorët janë përballë zgjedhjeve në një mjedis të kontrolluar, ku shpresohet, që variablat të jenë nën kontroll, dhe se zgjedhjet

shpërblehen duke kuptuar se të dy elementet e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme ndikojnë në zgjedhjen e produktit nga ana e konsumatorit (Richarme 2005).

3.3 Llojet kryesore të situatave të blerjës

Faza e blerjes është momenti kur konsumatori shkëmben paratë e tij me produktet (Blythe 2006). Sipas Kotler dhe Keller (2012), në fazën e vlerësimit konsumatori formon preferencat në mesin e një sërë markash dhe bën zgjedhjen, me qëllim për të blerë markën më të preferuar. Për të kryer blerjen konsumatori duhet të plotësojë pesë nënvendime.

- ✓ Marka
- ✓ Tregtari
- ✓ Sasia
- ✓ Koha
- ✓ Mënyra e pagesës

Me modelet e zgjedhjeve jo balancuese të konsumatorit, konsideratat pozitive dhe negative ndaj attributeve të produktit, jo domosdoshmërisht nxirren në pah apo shprehen. Vlerësimi i attributeve të izoluar e bën vendimmarrjen më të lehtë për konsumatorin, por ajo, gjithashtu, rrit gjatësinë që konsumatori mund të kishte bërë një zgjedhje të ndryshme, nëqoftëse do të shqyrtonte me detaje atributet. Duke nxjerrë në pah kështu tri zgjedhje orientuese heuristike (Kotler, Keller 2012).

Orientimi njohës.

Konsumatori vendos një nivel pranueshmërie për çdo atribut dhe zgjedh alternativën e parë, që plotëson standartet minimale për të gjitha atributet (Kotler, Keller 2012). Sipas Solomon (2011), orientimi njohës përfshin përpunimin e markës për ta zgjedhur atë në bazë të attributeve të paracaktuara, duke e marrë vendimin pasi janë identifikuar të gjitha atributet. Konsumatori zgjedh një markë nëse ajo i plotëson të gjitha atributet e paracaktuara, por nëse

marka dështon në përmbushjen qoftë edhe vetëm të një atributi, kjo do të thotë, se konsumatori do ta refuzojë atë markë, do të vonojë zgjedhjen, do të ndryshojë rregullin mbi vendimin, ose do të modifikojë atributet, të cilat i ka paravendosur në zgjedhjen e markës.

1. Orientimi leksikografik.

Konsumatori zgjedh markën më të mirë në bazë të perceptimit të atributit më të rëndësishëm (Kotler, Keller 2012). Sipas Solomon (2011), kur konsumatori përdor këtë rregull, ai zgjedh markën, që përfaqëson atributin më të rëndësishëm. Nëse ai mendon dy ose më shumë marka, që e kanë këtë atribut, konsumatori më pas krahason markat në lidhje me atributin e dytë më të rëndësishëm. Ky proces vazhdon deri në momentin, kur njëra nga markat plotësojnë atributet. Sipas Kardes, Cronley dhe Cline (2011), konsumatorët, që përdorin orientimin leksikografik, krahasojnë të gjitha markat bazuar në një atribut kryesor të tillë si: çmimi, madhësia, pesha, besueshmëria, qëndrueshmëria, kaloritë, sheqeri etj, dhe zgjedhin një markë, e cila përfaqëson më mirë në këtë atribut të vetëm dhe në përgjithësi injorojnë atributet e tjera.

2. Eliminimi i aspekteve orientuese.

Konsumatori krahason markat nga një atribut i zgjedhur rastësisht, ku mundësia e zgjedhjes së një atributi është i lidhur pozitivisht me rëndësinë e tij dhe eliminon markat, që nuk i plotësojnë minimumin e attributeve të dëshiruara (Kotler, Keller 2012). Sipas Solomon (2011), duke përdorur këtë metodë, blerësi i vlerëson markat bazuar në atributet më të rëndësishme. Në këtë rast ai merr në konsideratë markat, që i kanë këto attribute.

Sipas Kotler dhe Keller (2012), njohuria e konsumatorit në lidhje me markën ose produktin, numri i markave në zgjedhje, presioni i kohës dhe konteksti shoqëror, të gjitha së bashku mund të ndikojnë, që konsumatori të bëjë një zgjedhje duke përdorur një zgjedhje njohëse heuristike. Faktorët ndërhyrës - Edhe në qoftë se konsumatorët kanë vendosur për markën, kemi dy faktorë të përgjithshëm, që mund të ndërhyjnë midis qëllimit të blerjes dhe vendimit të blerjes.

Faktori i parë është qëndrimi i të tjerëve. Ndikimi i një personi tjetër varet nga dy aspekte

1. Intensiteti i qëndrimit negativ të personit tjetër, ndaj alternativës së preferuar nga konsumatori dhe

2. motivimi i konsumatorit për t'iu bindur dëshirës së personit.

Sa më i madh qëndrimi dhe afriteti i personit ndaj konsumatorit, aq më shumë do influencojë ai në procesin e blerjes dhe anasjelltas.

Një vendim i konsumatorit për të modifikuar, për të shtyrë, ose për të shmangur një vendim për blerje, është i ndikuar kryesisht nga një ose me shumë lloje të perceptimit mbi rreziqet e menduara (Kotler, Keller 2012). Këto rreziqe paraqiten si më poshtë vijon:

1. Rreziku funksional – Rasti, kur produkti nuk i ka pritshmëritë për konsumatorin.
2. Rreziku fizik – Rasti, kur produkti përbën një kërcënim për mirëqënien fizike, shëndetin e konsumatorit ose për të tjerët.
3. Rreziku financiar – Rasti, kur produkti nuk ka vlerën e çmimit të paguar për konsumatorin.
4. Rreziku shoqëror – Rasti, kur rezultatet e produktit e vënë konsumatorin në siklet para të tjerëve.
5. Rreziku psikologjik – Rasti, kur produkti ndikon në shëndetin mendor të konsumatorit.
6. Rreziku kohor – Rasti, kur dështimi në rezultatet e produktit është një kosto oportune e gjetjes së një tjetër produkti të kënaqshëm.

Sipas Solomon (2011), pasi mbledhen mundësitë dhe vlerësohen, më pas kryhet zgjedhja. Zgjedhja mund të ndikohet duke kombinuar informacionin me përvojat e mëparshme, informacionin e disponuar në momentin e blerjes dhe besimet, që janë krijuar mbi markat nga publiciteti.

Sipas Lamb, Hair dhe McDaniel (2011), në këtë fazë konsumatori duhet të vendosë,

- Nëse do blejë
- Kur ta blejë
- Çfarë të blejë (llojin e produktit dhe markën)
- Ku ta blejë (llojin e shitësit, shitës specifik, online ose në dyqan)
- Si do ta paguajë (vendimi i blerjes del nga vlerësimi i alternativave).

Konsumatori mund të vendosë për të mos blerë dhe për të kursyer para, ose ta shpenzojnë atë në një produkt krejt të ndryshëm. Konsumatori mund të vendosë për të blerë një sasi të vogël, për qëllime gjykimi mbi produktin. Vendimi për të blerë, shpesh, ndodh disa kohë para blerjes aktuale. Blerja është një angazhim financiar për të përvetësuar produktin ose shërbimin. Konsumatorët blejnë në një njësi shitje me pakicë (me qëllim blerjen e një marke) dhe ndonjëherë mund të përfundojnë duke blerë diçka të ndryshme. Kjo ndodh për shkak se blerja e fundit e konsumatorit, mund të jetë ndikuar nga faktorë të tillë si: mungesa e produktit, një ekran promovues, ose një mesazh bindës nga personeli i shitjes (Hollonsen 2010).

Dobia dhe vlera e produktit janë një rrëfyes i fortë i vendimeve të konsumatorëve për blerjen e produkteve. Konsumatorët kërkojnë dhe blejnë produkte dhe shërbime, që besojnë se janë të pajisura me dobitë dhe vlerat më të mira. Pastaj, pasi konsumatorët të kenë qasje për produktin ose shërbimin, ata zakonisht e konsumojnë atë. Ky lloj i veçantë i konsumit është quajtur konsum ritual, i cili i referohet një modeli të sjelljeve të lidhura me ngjarjet e jetës, që prekin atë dhe se si konsumatorët e konsumojnë. Këto sjellje priren të kenë kuptime simbolike dhe ndryshojnë shumë nga kultura (Grewal, Levy 2008).

3.4 Faktorët që ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve

Në kërkimet konsumatore ku studiohet sjellja e konsumatorit, kjo sjellje është e ndikuar nga karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike të konsumatorëve. Prandaj, është e nevojshme që jo vetëm karakteristikat demografike të konsumatorit të jenë të vetëdijshme, por edhe qëndrimet, interesat, opinionet, njohuritë, synimet dhe motivimet e konsumatorit, gjithashtu, të jenë të vetëdijshme (Solomon, Bamossy, Askegaard, Hogg 2006). Në kërkimet mbi konsumatorin vërehet se faktorë të ndryshëm ndikojnë në mënyrën se si konsumatorët blejnë mallra dhe shërbime. Këta faktorë mund të klasifikohen si faktorë kulturorë, si karakteristika individuale dhe si variabla psikologjike. Statusi shoqëror, familja dhe miqtë ndikojë në vendimet e konsumatorëve në blerjet e tyre. Ndikimi kulturor ka efekte në blerjet e konsumatorëve. Faktorët personalë përfshijnë moshën, të ardhurat, profesionin, mënyrën e jetesës, personalitetin dhe vetëkonceptimin. Ndryshimet në ndonjë nga këto faktorë mund të ushtrojnë ndikim mbi sjelljen e blerësve. Të ardhurat dhe mënyra e jetesës ndikojnë në dy procese, në atë të blerjes dhe zgjedhjes së produkteve. Kurse, faktorët psikologjikë ndikojnë sjelljen individuale të blerjes dhe se si njerëzit i përgjigjen metodave promovuese. Faktorët psikologjikë përfshijnë perceptimin, motivimin, qëndrimet dhe të mësuarit (Proctor 2005). Blerjet janë të ndikuara fuqishëm nga karakteristikat kulturore, sociale, personale dhe psikologjike. Marketerët nuk mund t'i kontrollojnë këta faktorë, por duhet t'i marrin në konsideratë ato (Kotler, Armstrong, Saunders, Wang 2006).

Faktorët kulturorë

Faktorët kulturorë ushtrojnë ndikimin më të gjerë dhe më të thellë në sjelljen e konsumatorit. Marketerët duhet t'i kuptojnë këto faktorë, që ndikojnë në sjelljen e blerësve si: kultura, nënkultura dhe klasa sociale (Kotler, Armstrong, Saunders, Wang 2006). Studimi i kulturës është një ndërmarrje e vështirë, për shkak se fokusi i tij kryesor janë sjelljet shoqërore të grupeve dhe të shoqërisë në tërësi. Ashtu sikurse psikologët, të cilët kryesisht merren me studimin e sjelljes individuale, apo sociologët, të cilët merren me studimin e grupeve edhe antropologët janë kryesisht

të interesuar në identifikimin dhe ndërtimin e vetë shoqërisë (Schifman, Kanuk, Hansen 2012). Kultura luan një rol të rëndësishëm në formësimin e sjelljes së konsumatorit. Ajo përfshin vlerat, besimet, zakonet dhe sjelljet që mësohen dhe ndahen nga një grup i caktuar njerëzish. Faktorët kulturorë ndikojnë në preferencat, qëndrimet dhe vendimet e blerjes së konsumatorëve. Për shembull, faktorët kulturorë ndikojnë ndjeshëm në sjelljen konsumatore të konsumatorëve myslimanë në kontekstin e produkteve ushqimore hallall (Khan I & Ghauri T. A, 2020).

Kultura

Kultura cilësohet si arsyeja apo shkaku më i thjeshtë që influencon në sjelljen konsumatore. Sjellja e njeriut është kryesisht e mësuar, i rritur në një shoqëri (si qenie sociale), fëmija mëson vlerat themelore, perceptimet, dëshirat dhe sjelljet nga familja dhe institucionet e tjera të rëndësishme (Kotler, Armstrong, Saunders, Wang 2006). Kultura është karakteri thelbësor i një shoqërie, që e dallon atë nga grupet e tjera (Lamb, Hair, McDaniel 2011). Elementet kryesore në çdo kulturë janë vlerat, gjuha, mitet, zakonet, ritualet dhe ligjet që i japin formë sjelljes së njerëzve. Po ashtu, objektet materiale apo produktet e një sjelljeje që transmetohet nga njëri brez në tjetrin, kulturën e përkufizojnë si ndarjet e përbashkëta të kuptimit, besimit, moralit, vlerave dhe zakoneve të një grupi njerëzish. Si faktor social, kultura ndikon vendimet e blerjes së konsumatorëve. Kulturat në të cilën konsumatorët bëjnë pjesë nuk janë shumë të ndryshme nga grupet e tyre të referencës. Ashtu si grupet e referencës, kultura influencon sjelljen mbi konsumin e produkteve dhe shërbimeve (Grewal, Levy 2008). Kultura përcaktohet si shuma totale e besimeve të mësuara, vlerave dhe zakoneve, që shërbejnë për të drejtuar sjelljen konsumatore si pjesëtarë të një shoqërie të caktuar (Schiffman, Kanuk, Hansen 2012).

Nënkultura

Kultura përmban pjesë të nënkulturave, që nënkupton një grup të veçantë dhe relativisht më të vogël brenda një shoqërie më të madhe që ndan modele unike besimesh, vlerash, sjelljesh dhe praktikash. Nënkulturat mund të marrin forma të ndryshme, duke filluar nga lëvizjet artistike, zhanret muzikore, tendencat e modës, aktivitetet rekreative, apo edhe grupet specifike të profesionit. Këto nënkultura shpesh zhvillojnë gjuhën e tyre, simbolet, ritualet dhe normat që i lidhin anëtarët e tyre së bashku dhe i veçojnë ata nga rryma kryesore. Shumë nënkultura përbëjnë segmente të rëndësishme të tregut dhe shpesh kur marketerët projektojnë, produktet i përshtaten nevojave të këtij lloji tregu. Një nënkulturë është një grup homogjen njerëzish të cilët ndajnë elementet e kulturës së përgjithshme dhe elementet unike të kulturës në grupin e tyre. Ndryshimet nënkulturore mund të ndikojnë në një kulturë në atë se si, kur dhe ku blejnë njerëzit mallra dhe shërbime (Kotler, Armstrong, Saunders, Wang 2006). Anëtarët e një nënkulture specifike posedojnë besime, vlera dhe zakone që i përcaktojnë ato veç e veç nga anëtarët e tjerë të së njëjtës shoqërie. Përveç kësaj, ata i përmbahen shumicës dominuese të besimeve kulturore, vlerave dhe modeleve të sjelljes të shoqërisë në tërësi. Nënkultura përcaktohet si një grup i veçantë kulturor, që ekziston si një segment i identifikueshëm brenda një shoqërie më të madhe e më komplekse (Schiffman, Kanuk, Hansen 2012).

Klasat shoqërore

Klasat shoqërore janë shoqëri ku anëtarët e të cilave ndajnë vlera, interesa dhe sjellje të ngjashme. Në vende të ndryshme të botës, klasat shoqërore ndryshojnë në madhësitë e tyre relative. Në vendet e zhvilluara dominon klasa e mesme shoqërore, ku është karakteristike struktura në formë diamanti. Kurse në vendet më pak të zhvilluara dominon struktura në formë piramide ku bazën e përbëjnë të varfërit. Disa sisteme klasash shoqërore kanë shumë ndikim mbi sjelljen e blerjes. Në shumicën e vendeve të zhvilluara klasat e ulëta tentojnë të zhvendosen lart me sjelljen e tyre blerëse duke imituar klasat e sipërme (Kotler, Keller 2012). Klasa shoqërore përkufizohet si ndarje hierarkike e shoqërisë, në grupe relativisht të qëndrueshme homogjene në lidhje me qëndrimet, vlerat dhe stilet e jetës (Hawkins, Mothersbaugh 2010). Klasa shoqërore përkufizohet si grupimi i anëtarëve të shoqërisë sipas statusit nga më i larti te më i ulëti. Këto klasa përbëhen nga grupe të identifikueshme individësh, sjelljet dhe stilet e jetës së të cilëve ndryshojnë nga ato të grupeve të tjerëve (Hayer 2010). Pothuajse të gjitha shoqëritë njerëzore

shfaqin shtresëzimin shoqëror më shpesh në formën e klasave shoqërore, si relativisht homogjene dhe të qëndrueshme në shoqëri, me anëtarë që mes tyre ndajnë vlera, interesa dhe sjellje të ngjashme (Kotler, Keller 2012). Kurse Lamb, Hair dhe McDaniel (2011), e cilësojnë një klasë shoqërore si një grup njerëzish, që konsiderohen pothuajse të barabartë në status apo në vlerësimin në komunitet, të cilët shoqërohen rreth tyre formalisht ose jo formalisht dhe ndajnë normat e sjelljes. Klasa shoqërore matet zakonisht si një kombinim i profesionit, i të ardhurave, i arsimimit, i pasurisë dhe i variablave të tjerë.

Faktorët shoqërorë

Sjellja e konsumatorit është e ndikuar nga faktorët shoqërorë, grupet e vogla shoqërore të konsumatorit, familjet, rolet shoqërore dhe statusi. Për shkak se këto faktorë ndikojnë fuqishëm në sjelljen e konsumatorit, kompanitë i marrin në konsideratë për ndërtimin e strategjive të tyre të marketingut. Gjithashtu, faktorët shoqërorë ndikojnë fuqimisht në sjelljen e blerësit. Këta faktorë formojnë sjelljen e konsumatorëve duke ndikuar në opinionet, aspiratat dhe zgjedhjet e tyre për blerje. Në një studim nga Kwon dhe Armstrong, u zbulua se grupet e referencës ndikojnë ndjeshëm në vendimet e blerjes së konsumatorëve, veçanërisht për produktet me përfshirje të lartë si telefonat inteligjentë (Kwon, H. S & Armstrong, K. L., 2020). Pozicioni i personit brenda secilit grup mund të përcaktohet në termat e rolit dhe statusit. Një blerës zgjedh produkte dhe marka të cilat pasqyrojnë rolin dhe statusin e tij (Kotler, Wong, Saunders, Armstrong 2005).

Grupet

Grupet ndikojnë në sjelljen e një personi. Grupet që kanë një ndikim direkt janë grupet e anëtarësimit të cilit i takon personi. Disa nga këto grupe janë:

Grupe parësore, prej të cilave ka lidhje të rregullta por informale të tilla si familja, fqinjët apo kolegët e punës.

Grupet dytësore janë grupe formale, të cilat përfshijnë organizata si grupe fetare, shoqatat profesionale dhe sindikatat.

Grupet e referencës janë ato grupe që shërbejnë si pika të drejtpërdrejta ose indirekte në referencën e formimit të qëndrimeve dhe sjelljeve të një personi. Zakonisht grupet e referencës, të cilave nuk u përkasim, ndikojnë te njerëzit (Kotler, Keller 2012). Njerëz të cilët i përkasin një grupi reference për shkak të aftësive të veçanta, njohurive, personalitetit dhe karakteristikave të

tjera, të cilët ushtrojnë ndikim mbi të tjerët. Të gjitha grupet formale ose joformale, të cilat ndikojnë në sjelljen e blerjes së një individi, janë grupet e referencës së atij personi. Konsumatorët mund të përdorin produkte ose marka për t'u identifikuar me një grup. Ata mësojnë duke vëzhguar, se si anëtarët e grupit të referencës së tyre konsumojnë dhe në këtë mënyrë përdorin të njëjtat kritere për të marrë vendimet e tyre të konsumit (Lamb, Hair, McDaniel, 2011). Një grup reference është një ose më shumë persona, të cilët një individ i përdor si bazë për krahasimin me bindjet, ndjenjat dhe sjelljet. Një konsumator mund të ketë grupe të ndryshme reference duke përfshirë familjen, miqtë, bashkëpunëtorët. Këto grupe referencash ndikojnë vendimet e blerjeve si dhe ofrojnë informacion, sigurojnë shpërblime për sjelljet e blerjeve dhe rritin vetëvlerësimin e konsumatorit. Grupet e referencës të japin informacion për konsumatorët drejtpërdrejtë përmes bisedës ose indirekt përmes vëzhgimit (Grewal, Levy 2008). Sipas Kotler, Wong, Saunders dhe Armstrong (2005) dhe Kotler dhe Keller (2006) grupet e referencës ndikojnë në një person në së paku tri mënyra:

- a) ekspozojnë personin në sjellje dhe mënyra jetese të reja,
- b) ndikojnë në qëndrimet e personit dhe vetëkonceptimin (sepse ai apo ajo dëshirojnë të përshtaten),
- c) krijojnë presione përshtatjeje, të cilat mund të ndikojnë te personi në zgjedhjen e produktit dhe markës.

Faktorët psikologjik

Faktorët psikologjik luajnë një rol vendimtar në kuptimin e sjelljes së konsumatorit. Këta faktorë thellohen në proceset njohëse dhe emocionale që ndikojnë në vendimmarrjen e individëve kur bëhet fjalë për blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Duke ekzaminuar këta faktorë psikologjik, tregtarët dhe bizneset mund të fitojnë njohuri të vlefshme për preferencat, motivimet dhe sjelljet e konsumatorëve, të cilat në fund mund t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë strategji efektive marketingu dhe të përshtatin ofertat e tyre për të përmbushur nevojat e konsumatorëve. Faktorët psikologjik, si perceptimi, motivimi, të mësuarit, qëndrimet dhe personaliteti, ndikojnë në sjelljen e konsumatorit. Ata përcaktojnë se si individët i perceptojnë dhe reagojnë ndaj stimuljeve të marketingut. Një studim hulumtues nga Hsiao dhe Yang ekzaminoi rolin e faktorëve psikologjik në sjelljen e blerjes me impuls në internet dhe zbuloi se motivimi dhe kënaqësia e perceptuar e konsumatorëve ndikojnë ndjeshëm në vendimet e tyre të blerjes impulsive (Hsiao,

T. M. & Yang, H. L., 2020). Le të shqyrtojmë disa faktorë kyç psikologjik dhe ndikimin e tyre në sjelljen e konsumatorit.

1. Perceptimi: Perceptimi i referohet mënyrës se si individët interpretojnë dhe kuptojnë stimujt nga mjedisi i tyre. Perceptimet e konsumatorëve ndikohen nga përvojat e tyre personale, besimet, vlerat dhe prejardhja kulturore. Tregtarët duhet të kuptojnë se si konsumatorët i perceptojnë produktet ose shërbimet e tyre, pasi ajo formëson qëndrimet e tyre dhe vendimet e blerjes. Faktorë të tillë si paketimi, marka dhe mesazhet reklamuese mund të ndikojnë ndjeshëm në perceptimet e konsumatorëve për cilësinë, vlerën dhe dëshirueshmërinë e një produkti.

2. Motivimi: Motivimi është forca lëvizëse pas sjelljes së konsumatorit. Ai përfshin faktorë racionalë dhe emocionalë që i shtyjnë individët të përmbushin nevojat dhe dëshirat e tyre përmes blerjes. Teoria e hierarkisë së nevojave të Maslow sugjeron që konsumatorët motivohen nga nevoja të ndryshme, të tilla si nevojat fiziologjike, të sigurisë, sociale, të vlerësimit dhe të vetëaktualizimit. Tregtarët mund të shfrytëzojnë këto motivime duke i pozicionuar produktet e tyre si zgjidhje për nevojat e konsumatorëve dhe duke shfrytëzuar apelet emocionale për të krijuar dëshirë dhe aspiratë.

Faktorët ekonomik

Faktorët ekonomik luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e sjelljes së konsumatorit. Këta faktorë përfshijnë konsideratat financiare dhe kufizimet me të cilat përballen individët kur marrin vendime për blerje. Të kuptuarit e faktorëve ekonomik që ndikojnë në sjelljen e konsumatorit është thelbësor për bizneset që të zhvillojnë strategji çmimesh, promovime dhe oferta produktesh që përputhen me aftësitë dhe motivimet financiare të konsumatorëve. Faktorët ekonomik, duke përfshirë të ardhurat, çmimin dhe punësimin, ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve duke ndikuar në fuqinë blerëse dhe gatishmërinë për të shpenzuar. Gjatë rënies ekonomike, konsumatorët priren të jenë më të ndjeshëm ndaj çmimeve dhe të kenë përparësi blerjet thelbësore. Një studim nga Dur et al. hetoi ndikimin e faktorëve ekonomikë në sjelljen e konsumatorëve gjatë pandemisë COVID-19 dhe zbuloi se pasiguria ekonomike ndikoi ndjeshëm në sjelljen e shpenzimeve të konsumatorëve (Dur, U., Kivrak, S., & Arslan, F., 2020). Këtu janë disa faktorë dhe referenca kryesore ekonomike për të eksploruar më tej këtë temë:

1. Të ardhurat: Niveli i të ardhurave është një faktor ekonomik vendimtar që ndikon në fuqinë blerëse dhe sjelljen blerëse të konsumatorëve. Konsumatorët me të ardhura më të larta priren të kenë më shumë të ardhura të disponueshme, duke i lejuar ata të bëjnë blerje luksoze dhe të investojnë në mallra dhe shërbime me çmime më të larta. Nga ana tjetër, konsumatorët me të ardhura më të ulëta mund të fokusohen në nevojat thelbësore dhe të kërkojnë opsione të orientuara nga vlera. Të kuptuarit e shpërndarjes së të ardhurave dhe segmenteve të konsumatorëve mund t'i ndihmojë bizneset të përshtatin ofertat e tyre në përputhje me rrethanat.
2. Ndjeshmëria ndaj çmimit: Ndjeshmëria ndaj çmimit i referohet reagimit të konsumatorëve ndaj ndryshimeve në çmimet e produkteve. Disa konsumatorë janë shumë të ndjeshëm ndaj çmimit dhe i japin përparësi gjetjes së ofertës më të mirë ose optionit me çmimin më të ulët, ndërsa të tjerë janë të gatshëm të paguajnë një çmim për cilësi më të lartë ose veçori unike. Bizneset duhet të marrin në konsideratë elasticitetin e çmimeve dhe segmentet e konsumatorit kur vendosin çmimet për të maksimizuar përfitimin dhe për të përmbushur kërkesat e grupeve të ndryshme të klientëve.
3. Kushtet ekonomike: Kushtet ekonomike, si rritja ekonomike, inflacioni, normat e papunësisë dhe normat e interesit, kanë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e konsumatorëve. Gjatë periudhave të rritjes ekonomike dhe papunësisë së ulët, konsumatorët priren të kenë më shumë besim dhe të ardhura të disponueshme, duke çuar në rritjen e shpenzimeve. Në të kundërt, gjatë rënieve ekonomike ose recesioneve, konsumatorët mund të shtrëngojnë buxhetet e tyre dhe t'u japin përparësi blerjeve thelbësore. Monitorimi dhe përshtatja me kushtet ekonomike janë thelbësore që bizneset të përshtatin strategjitë e tyre në përputhje me rrethanat.

Faktorët personal

Faktorët personal luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e sjelljes së konsumatorit. Këta faktorë janë të brendshëm për individët dhe ndikojnë në proceset e tyre vendimmarrëse dhe sjelljet e blerjeve. Kuptimi i këtyre faktorëve personal është thelbësor për tregtarët dhe bizneset pasi ato ndihmojnë në zhvillimin e strategjive efektive të marketingut dhe në shënjestrimin e segmenteve të duhura të konsumatorëve. Faktorët personal përfshijnë moshën, gjininë, stilin e jetës, profesionin dhe preferencat individuale. Këta faktorë ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve duke formësuar nevojat, dëshirat dhe proceset e vendimmarrjes së tyre. Një studim nga Chatterjee dhe Vatavwala ekzaminoi ndikimin e faktorëve personal në preferencat e markës së

konsumatorëve dhe zbuloi se mosha dhe mënyra e jetesës ndikojnë ndjeshëm në zgjedhjet e markës së konsumatorëve (Chatterjee, M. & Vatavwala, H., 2020).

Këtu janë disa faktorë kryesorë personalë që ndikojnë në sjelljen e konsumatorit:

1. Mosha dhe faza e jetës: Grupmosha të ndryshme kanë nevoja, preferenca dhe modele të ndryshme blerjesh. Konsumatorët në faza të ndryshme të jetës, si adoleshentët, të rinjtë, prindërit ose pensionistët, kanë kërkesa dhe motivime unike. Për shembull, adoleshentët mund të jenë më të prirur drejt modës dhe teknologjisë në modë, ndërsa pensionistët mund t'i japin përparësi aktiviteteve shëndetësore dhe të kohës së lirë.
2. Gjinia: Gjinia është një tjetër faktor i rëndësishëm personal që ndikon në sjelljen e konsumatorit. Burrat dhe gratë shpesh kanë preferenca dhe sjellje të ndryshme blerëse. Tregtarët marrin parasysh dallimet gjinore kur dizajnojnë produkte, paketime dhe mesazhe reklamuese për të synuar në mënyrë efektive gjinitë specifike.
3. Personaliteti dhe mënyra e jetesës: Personaliteti dhe mënyra e jetesës së konsumatorëve ndikojnë shumë në vendimet e tyre për blerje. Tiparet e personalitetit si ekstroversioni, ndërgjegjja dhe hapja ndaj përvojave të reja mund të ndikojnë në zgjedhjet e produktit. Mënyrat e jetesës, duke përfshirë aktivitetet, interesat dhe opinionet, mund të formojnë preferencat për disa marka ose kategori produktesh.
4. Vetë-koncepti dhe identiteti: Vetë-koncepti dhe identiteti i konsumatorëve luajnë një rol në zgjedhjet e tyre të konsumit. Njerëzit shpesh blejnë produkte ose marka që përputhen me imazhin e tyre për veten ose identitetin e dëshiruar. Për shembull, dikush që e percepton veten si të vetëdijshëm për mjedisin mund të preferojë produkte ekologjike.
5. Motivimi dhe perceptimi: Motivimi i referohet shtysave themelore që i shtyjnë individët të kënaqin nevojat e tyre përmes konsumit. Këto nevoja mund të jenë funksionale, sociale, emocionale ose psikologjike. Perceptimi, nga ana tjetër, i referohet mënyrës se si individët interpretojnë dhe kuptojnë stimujt në mjedisin e tyre. Tregtarët mund të ndikojnë në sjelljen e konsumatorit duke apeluar në motive specifike dhe duke formësuar perceptimet e konsumatorëve.

3.5 Kënaqësia konsumatore dhe lojaliteti

Organizatat që janë të fokusuara në konsumatorin e shohin matjen e kënaqësisë konsumatore si mjet për përmirësim të vazhdueshëm. Kur një organizatë kupton sa të kënaqur janë konsumatorët e saj, dhe pse, mund të fokusohet në kohën dhe resurset që ka në mënyrë më efektive. Kënaqësia konsumatore i mundëson kompanive të kuptojnë edhe faktorët tjerë të cilët nuk mund t'i kontrollojnë (media) (HM Government, 2007). Sipas Rana, Osman dhe Islam (2014) kënaqësia konsumatore është një indikator se sa me sukses organizata po i plotëson kërkesat konsumatore. Të gjitha aktivitetet e dyqaneve me pakicë drejtohen tek kënaqësia konsumatore që ndikon në mbajtjen e konsumatorëve – një faktor shumë i rëndësishëm për rritje të biznesit. Në një ambient biznesor ku vazhdimisht po rritet konkurrenca, kompanitë duhet të jenë të orientuara nga konsumatori. Për të forcuar orientimin drejtë konsumatorit në baza ditore, një numër i madh i kompanive zgjedhin kënaqësinë konsumatore si indikatorin më të rëndësishëm të performancës. Kënaqësia konsumatore mundëson ruajtjen e konsumatorëve, në këtë mënyrë arrihet rritja dhe profiti biznesor. Një konsumator i kënaqur mund të jetë lojal. Këta të fundit blejnë më shumë prej kompanisë, provojnë gamën e re të produkteve të kompanisë, flasin gjëra pozitive tek tjerët, nuk i japin vëmendje markave tjera të konkurrencës si dhe janë më pak sensitiv ndaj çmimit (Rana, Osman dhe Islam, 2014). Cengiz (2010) tregoi se matja e kënaqësisë konsumatore ka rëndësi shumë më të madhe sesa vetëm konsumatorët e kënaqur. Kjo matje ka rëndësi për profitin dhe avantazhin konkurrues. Matja e kënaqësisë konsumatore ofron një pamje tek sjelljet e konsumatorëve para dhe pas blerjes. Pa këtë qasje, kuptimi, përmirësimi dhe zhvillimi i shërbimeve më të mira për konsumatorët nuk do të ishte i mundshëm.

Përmes matjeve të kënaqësisë konsumatore, biznesit i mundësohet (Cengiz, 2010):

1. Të kuptojë si po funksionojnë proceset biznesore.
2. Të kuptojë kur të bëhen ndryshimet për të krijuar përmirësime.
3. Të kuptojë nëse ndryshimet janë të nevojshme.
4. Të kuptojë nëse këto ndryshime sjellin përmirësime në kompani.

Aspektet pozitive – kompanitë që kërkojnë të bëjnë kënaqësi të lartë konsumatore kanë më shumë gjasa të kenë fitime më të mëdha. Duhet kuptuar se këto fitime nuk realizohen menjëherë. Kënaqësia konsumatore ofron mundësi biznesore në të ardhmen, ku një konsumator i

kënaqur është lojal ndaj kompanisë, që tregon një stabilitet të lëvizjes së keshit në të ardhmen (Ako-Nai, 2011).

Aspektet negative – një konsumator që është i kënaqur me një produkt ose shërbim do të rrisë frekuencën e blerjes dhe pritjet e së ardhmes. Për shkak të pritshmërive të larta të konsumatorëve do të bëhet shumë më e vështirë për kompaninë të ofrohet kënaqësia konsumatore në radhën tjetër të blerjes. Kjo mund të dëmtojë ecjen afatgjatë të kompanisë. Përveç kësaj, do të rriten kostot për të përmirësuar tiparet e produkteve në mënyrë që konsumatorët të jenë të kënaqur (Ako-Nai, 2011).

Barrierat për të pasur kënaqshmërinë konsumatore

Shumë kompani kanë kuptuar nevojën për të ofruar një shërbim konsumator. Por, shumë shpesh kjo është vetëm e paraqitur në fletë. Shërbimi aktual ose kualiteti i atij shërbimi shumë shpesh nuk është i pranishëm. Kjo ndikon në pakënaqësin e konsumatorëve. Disa prej barrierave për të ofruar kënaqësinë konsumatore janë (Ako-Nai, 2011):

1. Stafi i mbingarkuar – kjo mund të shkaktohet si rezultat kur nuk ka staf të mjaftueshëm, ka rritje të shpejtë ose kanë shumë detyra për të kryer. Në këtë mënyrë stafi do të humbas energji. Në këtë mënyrë konsumatorët nuk do të marrin mjaftueshëm vëmendje.
2. Stafi shumë i lirë - nëse stafi është shumë i lirë dhe ndjehet i parëndësishëm. Ky lloj i stafit ndikon që rastet e ndryshme ti kryej me vonesë, duke ndikuar në frustrimin e konsumatorëve.
3. Kultura e pakujdesshme – kultura brenda punës ndikon në atë se si rastet e shërbimit konsumator trajtohen. Kjo kulturë parandalon stafin për t'u kujdesur mjaftueshëm për konsumatorët. Në këtë mënyrë konsumatorët nuk mbasin prioritet, duke krijuar paknaqësi tek ta.
4. Përgjegjësia e dobët – nëse stafi nuk është përgjegjës për shërbimin ndaj konsumatorëve, nuk ka arsye pse të mundohen më shumë për të kënaqur konsumatorët.
5. Sisteme të pamjaftueshme – nëse sistemet me të cilat punon me klientët janë të dobëta, ose të ngadalta, kanë mungesë të të dhënave, kjo do të shkaktojë gjithmonë problem. Konsumatorët nuk do të jenë të kënaqur kur ka pritje të gjata për të kryer një shërbim.
6. Komunikimi i vlerës së konsumatorëve – i gjithë stafi i kompanisë duhet të kujtohet se sa të vlefshëm konsumatorët janë, në këtë mënyrë stafi do të kuptojë si të sillet me konsumatorët.
7. Mungesa e stimuljeve – duhet vlerësuar stafi që ka sjellje të mirë me klientët. Në këtë mënyrë ata do të motivohen dhe do të mundohen ende për të qenë më të mirë ndaj konsumatorëve.

Industria e shitësve me pakicë është një prej industrive më të mëdha dhe shumë profitabile në botë. Ky sektor është rritur më së shumti në krahasim me disa sektorë tjerë global dhe ka hasur revolucione të ndryshme. Duke filluar nga dyqanet e vogla lokale më 1900 e deri tek koha me uebfaqet e-commerce. Këto kanë filluar si dyqane në qoshe të vendeve të ndryshme duke vazhduar në markete të mëdha, e më pas edhe në qendra të mëdha tregtare që janë bërë pikë referimi e shumë shteteve të mëdha të botës (Rahate, 2015).

Disa prej shitësve me pakicë më të njohur e njëkohësisht më të suksesshëm janë (Rahate, 2015):

1. Metro AG – me origjinë nga Gjermania, e themeluar më 1964. Ka 384 hipermarkete, 137 markete të mëdha, dhe 948 dyqane të elektronikës në gjithë botën.
2. Lidl Stiftung & Co.KG – me origjinë nga Gjermania, e themeluar më 1930. Prezenca e Lidl është në më shumë se 20 vende me rreth 9.800 shitore të hapura.
3. Kroger Co. – me origjinë nga SHBA-të, e themeluar më 1883. Ka më shumë se 2.600 shitore dhe është kompania e 23-të në botë për nga madhësia.
4. Carrefour S.A. – me origjinë nga Franca, e themeluar më 1958. E vendosur në më shumë se 10.000 lokacione në botë.
5. Costco Wholesale Corporation – me origjinë nga SHBA-të, e themeluar më 1978. Përveç SHBA-ve është prezente në vetëm tetë shtete tjera.
6. Tesco PLC – me origjinë nga Anglia, e themeluar më 1919. Ka rreth 7.300 dyqane në botë.
7. Wal-mart Stores. Inc. – me origjinë nga SHBA-të, e themeluar më 1945. Operon në 27 vende me më shumë se 11.000 shitore në botë. Operon me 55 emra të ndryshëm në vende të ndryshme duke krijuar partneritet me kompani tjera (Rahate, 2015).

KAPITULLI IV. METODOLIGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë punim janë përdorur dy lloje të burimeve të të dhënave, ato primare dhe sekondare. Të dhënat sekondare janë mbledhur nga literatura të autorëve të ndryshëm, artikuj dhe publikime të ndryshme nëpër revista shkencore. Në pjesën praktike të dhënat janë grumbulluar me metodën sasiore të mbledhjes së të dhënave, duke përdorur pyetësin anketues ku janë anketuar 230 konsumatorë të kompanive Telekom dhe A1.Ky pyetësor ka gjithsej 34 pyetje. Për plotësimin e këtij pyetësori është shfrytëzuar metoda online.

4.1 Përcaktimi i hipotezave

- H1. Marketingu digjital ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- H2. Kënaqësia ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- H3. Cilësia e shërbimit ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- H4. Ankesat e shërbimit kanë ndikim të rëndësishëm pozitiv në lojalitetin e konsumatorëve;
- H5. Lojaliteti ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në WOM (fjalën e gojës).

4.2 Zgjedhja e mostrës

Mostra është një pjesë e vogël e grupit themelor (popullimit- bashkësisë themelore) në bazë të së cilës nxjerrim përfundim lidhur me popullimin (Livoreka, 2011).

